



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 48

2001

Tetor

### P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.8819 datë 27.9.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtian “Për zhvillimin ekonomik arab” për projektin e dytë të rehabilitimit të ujitjes” ..... 1515
Ligj nr.8820 datë 27.9.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Kredisë të Zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Shpërndarja e Shërbimeve Sociale”” ..... 1527
Ligj nr.8821 datë 15.10.2001	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën Ndërkombëtare të Eurocontrol-it” ..... 1542
Ligj nr.8822 datë 15.10.2001	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.5, datë 31.8.2001 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”” ..... 1543
Ligj nr. 8823, datë 18.10.2001	Për Buxhetin faktik të vitit 2000 ..... 1543

Vendim i KM nr.563, datë 13.10.2001	Për dhënie ndihme të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit .....	1544
Vendim i GJK nr.102, datë 28.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për mosshpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin në zonën zgjedhore nr.60”. .....	1545
	<i>Vendim</i> (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Gjyzel Fida.....	1550
	<i>Vendim</i> (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Atli Hakore .....	1550
	<i>Vendim</i> (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetases Magdalena Toma .....	1550
	<i>Vendim</i> (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Urim Topuzi .....	1550
	<i>Kërkesë</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lutfi Mara .....	1550
	<i>Kërkesë</i> për vërtetimin e faktit juridik të vdekjes së shtetases Mine Çeliku .....	1551
	<i>Kërkesë</i> për shpalljen të vdekur të shtetasit Artan Xhukellari.....	1551
	<i>Kërkesë</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Halit Ferhati .....	1551

**L I G J**  
**Nr. 8819, datë 27.9.2001**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT KUAJTIAN “PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB”, PËR PROJEKTIN E DYTË TË REHABILITIMIT TË UJITJES”**

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtian “Për zhvillimin ekonomik arab” për projektin e dytë të rehabilitimit të ujitjes”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3114, datë 3.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**MARRËVESHJA**  
**E HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT KUAJTIAN PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB**

**PROJEKTI I DYTË I REHABILITIMIT TË UJITJES**  
**(FAZA II)**

Marrëveshja e datës 5.2.2001 midis Republikës së Shqipërisë (e quajtur këtej e tutje Huamarrësi) përfaqësuar nga Qeveria e Shqipërisë nga njëra anë dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab (i quajtur këtej e tutje Fondi) nga ana tjetër.

Huamarrësi i kërkuar Fondit ta ndihmojë në financimin e Projektit të Dytë të Rehabilitimit të Ujitjes të përshkruar në listën 2 të kësaj Marrëveshjeje (i quajtur këtej e tutje Projekt);

Huamarrësi ka siguruar nga Shoqëria Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA) një kredi me një shumë ekuivalente me 24 milionë dollarë, nga e cila shuma prej 12 milionë dollarë do të disloket për të ndihmuar në financimin e Projektit;

Huamarrësi zotohet të financojë koston e vlerësuar të Projektit që mbetet e pambuluar në monedhë lokale apo të huaj dhe çdo kosto tjetër që mund të rezultojë;

Qëllimi i Fondit është të ndihmojë vendet arabe dhe vendet e tjera në zhvillim për zhvillimin e ekonomisë së tyre, dhe t’u sigurojë atyre huatë e nevojshme për kryerjen e projekteve e programeve të tyre të zhvillimit; dhe

Fondi e kupton rëndësinë dhe dobishmërinë e Projektit në zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit; dhe

Fondi është dakord që sa më sipër, t’i japë një hua Huamarrësit sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje.

Prandaj palët bien dakord si më poshtë:

## Neni 1

### **Huaja, interesi dhe detyrimet e tjera ripagimi; vendi i pagesës**

PARAGRAFI 1.01 Fondi është dakord që t'i japë hua Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje, një shumë ekuivalente me tre milionë e pesëqind mijë Dinarë Kuvajtian, (K.D 3 500 000).

PARAGRAFI 1.02 Huamarrësi do të paguajë një interes prej dy për qind (2%) në vit të shumës kryesore të huasë së tërhequr dhe të papaguar. Interesi do të fillojë nga data përkatëse që do të tërhiqen shumat.

PARAGRAFI 1.03 Do të paguhet një detyrim shtese prej zero pikë pesë përqind (1/2 e 1%) në vit në shumat e tërhequra nga huaja dhe të papaguara, për të përballuar shpenzimet administrative si dhe shpenzimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

PARAGRAFI 1.04 Detyrimi i paguar për angazhimet speciale të futura nga Fondi, me kërkesën e Huamarrësit sipas Paragrafit 3.02 të kësaj Marrëveshjeje, do të jetë 0.5% (1/2 e 1%) në vit e shumës kryesore të çdo angazhimi special të papaguar.

PARAGRAFI 1.05 Interesat dhe detyrimet e tjera do të llogariten duke pasur si bazë 360 ditë të vitit dhe 12 muaj (30 ditë) për çdo periudhë më të shkurtër se 6 - mujore.

PARAGRAFI 1.06 Huamarrësi do të paguajë pjesën kryesore të Huasë sipas neneve të Ripagimit të paraqitur në Listën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

PARAGRAFI 1.07 Interesat dhe detyrimet e tjera do të paguhen në periudha gjysmëvjetore në 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

PARAGRAFI 1.08 Huamarrësi ka të drejtë për pagesat e të gjithë interesit të rrjedhur dhe detyrimeve të tjera, për jo më pak se 45 ditë, të njoftojë Fondin për të paguar me avancë:

a) të gjithë shumën e huasë në kohën e caktuar,

b) të gjithë shumën e një ose më shumë periudhave, me kusht që në datën e kësaj parapagese nuk do të paguhet ndonjë pjesë e huasë pas asaj pjese që parapaguhet.

PARAGRAFI 1.09 Shuma e Huasë, interesi, si dhe detyrimet e tjera të saj, do të paguhen në Kuvajt ose në vende të tjera që Fondi do t'i quajë të arsyeshme.

## Neni 2

### **Sigurimi i parasë**

PARAGRAFI 2.01 Të gjitha llogaritë e trasaksioneve financiare të zbatuara në këtë Marrëveshje si dhe të gjitha shumat që hyjnë këtu, do të paguhen në Dinarë Kuvajtian.

PARAGRAFI 2.02 Sipas kësaj Marrëveshjeje, Fondi do të sigurojë, me kërkesën dhe duke vepruar si agjent për Huamarrësin, aq para sa mund të kërkohen për pagesën e kostos së mallrave për t'u financuar nga Huaja ose për kthimin e një kostoje të tillë në atë monedhë në të cilën ajo kërkohet. Shuma që do të gjykohet për t'u tërhequr nga Huaja do të jetë e barabartë me shumën në Dinarë Kuvajtian të kërkuar për blerjen e shumës përkatëse të valutës.

PARAGRAFI 2.03 Kur ripagesa e shumës kryesore ose pagesa e interesit dhe detyrimeve të tjera mbi Huanë është bërë, Fondi me kërkesën dhe veprimin si një agjent për Huamarrësin, mund të sigurojë shumën e Dinarëve Kuvajtianë të kërkuar për një ripagesë të tillë, siç mund të jetë rasti, kundrejt pagesës nga Huamarrësi të shumës së kërkuar për këtë blerje në valutë ose valuta, siç mund të pranohet kohë pas kohe nga Fondi. Çdo pagesë që do t'i bëhet Fondit dhe që do të kërkohet në këtë Marrëveshje do të konsiderohet e efektshme vetëm kur Dinarët Kuvajtianë janë marrë nga Fondi.

PARAGRAFI 2.04 Kurdo që të jetë e nevojshme për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, për të përcaktuar vlerën e një monedhe në raport me një tjetër, kjo vlerë do të jetë e përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Fondi.

### Neni 3

#### **Tërheqja dhe përdorimi i të ardhurave të Huasë**

PARAGRAFI 3.01 Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga Huaja shumat e shpenzuara ose që shpenzohen për Projektin, në përputhje me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje.

Me përjashtim të rasteve kur Fondi mund të bjerë dakord ndryshe, asnjë shumë nuk do të tërhiqet nga Huaja për llogari të shpenzimeve të bëra përpara datës 1.1.2000.

PARAGRAFI 3.02 Sipas kërkesës së Huamarrësit dhe sipas afateve dhe kushteve që do të bihet dakort midis Fondit dhe Huamarrësit, Fondi mund të fillojë bisedimet (zotimet) e veçanta me shkrim, për t'i paguar shumat Huamarrësit, përsa i përket kostos së mallrave që do të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje, duke pasur parasysh pezullimet apo anulimet pasuese.

PARAGRAFI 3.03 Kur Huamarrësi do të dojë të tërheqë ndonjë shumë nga Huaja ose t'i kërkojë Fondit të fillojë bisedimet e veçanta sipas paragrafit 3.02, Huamarrësi do t'i dërgojë Fondit një kërkesë me shkrim në një formë të tillë, duke përmbajtur ato deklarata, marrëveshje e dokumente të tjera, që Fondi do t'i quajë të arsyeshme.

Kërkesat për tërheqje me dokumentacionin e nevojshëm, siç thuhet në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Fondi do të bien dakord ndryshe, do të bëhen menjëherë në lidhje me shpenzimet për Projektin.

PARAGRAFI 3.04 Huamarrësi do ta pajisë Fondin me dokumentet dhe evidencat, në mbështetje të kërkesës për tërheqje, siç do të kërkojë Fondi, në qoftë se Fondi më parë ose më pas do të ketë lejuar ndonjë tërheqje të kërkuar në lutje.

PARAGRAFI 3.05 Çdo kërkesë për tërheqje, e shoqëruar me dokumentet dhe evidencat e tjera, duhet të jetë e mjaftueshme për nga forma dhe përmbajtja për ta bindur Fondin që Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga Huaja shumën dhe që shuma që tërhiqet nga kjo Hua përdoret vetëm për qëllimet e caktuara në Marrëveshje.

PARAGRAFI 3.06 Huamarrësi do t'i përdorë të ardhurat e Huasë vetëm për të financuar koston e mallrave të kërkuara për të kryer Projektin e përshkruar në Listën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Mallrat specifike që financohen prej Huasë, metodat dhe procedurat për sigurimin e këtyre mallrave do të përcaktohen me marrëveshje midis Fondit dhe Huamarrësit, e cila mund të ndryshohet me marrëveshje midis tyre.

PARAGRAFI 3.07 Huamarrësi do t'i përdorë të gjitha mallrat e financuara prej të ardhurave të Huasë vetëm në realizimin e Projektit.

PARAGRAFI 3.08 Pagesa nga Fondi e shumave të cilat Huamarrësi ka të drejtë t'i tërheqë nga Huaja, do të bëhen me urdhër të Huamarrësit.

PARAGRAFI 3.09 E drejta e Huamarrësit të tërheqë nga Huaja do të përfundojë në 30 qershor 2003 ose në një datë tjetër për të cilën mund të bien dakord, herë pas here, midis Huamarrësit dhe Fondit.

### Neni 4

#### **Marrëveshjet e veçanta**

PARAGRAFI 4.01 (a) Huamarrësi do t'i besojë Njesisë së Zbatimit të Projektit, e themeluar brenda Rregulloreve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në datën 5 prill 1999, (këtej e tutje e quajtur Njësia) kryerjen e Projektit dhe, për këtë qëllim, do t'i sigurojë këtë Hua kësaj Njësie.

(b) Huamarrësi do t'i sigurojë Njesisë staf të përshtatshëm, të gjitha mjetet dhe fondet e nevojshme për zbatimin e Projektit me efikasitet.

PARAGRAFI 4.02 Huamarrësi do të koordinojë dhe monitorizojë zbatimin e projektit dhe do të mbikqyrë shlyerjen e detyrimeve të përfutuesve në përputhje me politikën dhe procedurat e hartuara në Ligjin e Ujitjes dhe Kullimit, gjë që siguron realizimin e objektivave të Projektit.

PARAGRAFI 4.03 Në kuadrin e Huasë dhe shumës së dislokuar nga IDA për Projektin, Huamarrësi do t'i përdorë menjëherë të gjitha shumat e tjera të nevojshme në monedhë lokale apo të huaj, që do të kërkojnë për realizimin e Projektit, apo të çdo kostoje tjetër që mund të rezultojë, sipas afateve dhe kushteve të kënaqshme për Fondin.

PARAGRAFI 4.04 Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që të njoftojë Fondin për përgatitjen, studimet, planet dhe specifikimet për Projektin, afatet e ekzekutimit të tij dhe ndonjë modifikim material i bërë këtej e tutje, me ato hollësi, siç mund t'i kërkojë Fondi kohë pas kohe.

PARAGRAFI 4.05 Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që të kryejë Projektin me kujdesin dhe efektivitetin e duhur, si dhe në përputhje me praktikën e plotë inxhinierike, bujqësore, administrative dhe financiare.

PARAGRAFI 4.06 Për të kryer Projektin, Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që të punësojë konsulentë inxhinierë të përshtatshëm dhe, sipas afateve dhe konditave të kënaqshme për Fondin, të përgatisë dokumentet për tenderat e punimeve civile dhe supervizionin e punimeve të Projektit.

PARAGRAFI 4.07 Dhënia e kontratave për kryerjen e Projektit, të cilat do të financohen nga procedurat e Huasë dhe çdo ndryshim në to do të jenë subjekt i aprovimit të Fondit.

PARAGRAFI 4.08 (a) Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që të mbajë dokumentacione të përshtatshme për të identifikuar mallrat e financuara prej Huasë, të sigurojë përdorimin e tyre vetëm për Projektin, të ndjekë progresin e Projektit (duke përfshirë edhe koston) dhe të reflektojë, në përputhje me praktikën e llogarisë së plotë praktikën financiare dhe veprimtarinë e Njesisë, do të krijojë mundësitë për përfaqësuesit e akredituar të Fondit që të bëjnë vizita për qëllime lidhur me Huanë, të shqyrtojnë Projektin, mallrat dhe çdo dokument përkatës dhe do t'i japë Fondit të gjitha informacionet që Fondi do të kërkojë, në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me shpenzimet që lidhen me Huanë, Projektin, mallrat dhe gjendjen financiare dhe veprimtarinë e Njesisë, në lidhje me Projektin.

(b) Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë (i) të mbajë një llogari speciale për Fondin; (ii) të mbajë dokumentacionin e burimeve financiare dhe kostot përkatëse; dhe (iii) të kryejë kontrole periodike për të siguruar që dokumentacioni financiar është i besueshëm, i kompletuar dhe në përputhje me afatet kohore.

(c) Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë, që në përputhje me Projektin, të mbajë në dispozicion gjendjen e saj financiare për çdo kontroll financiar vjetor që do të kryhet nga revizorë të pavarur e të pranuar nga Fondi, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar dhe të sigurojë Fondin brenda një periudhe 6 - mujore nga mbyllja zyrtare e vitit financiar me një kopje të vlerësimeve të kontrollit financiar.

(d) Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që, brenda një periudhe 6 - mujore nga mbyllja zyrtare e vitit financiar t'i sigurojë Fondit (i) një buxhet të konsoliduar që të tregojë të ardhurat dhe shpenzimet e FSHPU-ve dhe SHPU-ve brenda zonës ku shtrihet Projekti; dhe (ii) një kontroll financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve të konsoliduara për secilën nga FSHPU-të apo SHPU-të e përmendura më lart.

PARAGRAFI 4.09 Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë për të garantuar me sigures të përshtatshëm të gjitha mallrat e financuara prej Huasë. Një sigurim i tillë do të mbulojë rreziqe të tilla si transporti dhe incidente të tjera me rrezik për blerjet dhe importet e mallrave në territoret e Huamarrësit dhe dorëzimit të tyre në zonën e Projektit dhe do të jetë, për shumën të tilla, sa do të jenë edhe praktikën e plota tregtare. Ky sigurim do të paguhet me monedhën me të cilën paguhet kostoja e mallrave të siguruara ose me monedhën e konvertueshme lirisht.

Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë të nxjerrë e të mbajë, me sigures të përshtatshëm përgjegjës, sigurimin kundrejt rreziqeve në zbatimin e Projektit në shumën të tilla të pajtueshme me praktikën tregtare.

PARAGRAFI 4.10 Huamarrësi dhe Fondi do të kooperojnë plotësisht për të siguruar realizimin e qëllimit të huasë. Në fund, Huamarrësi do të caktojë Njësinë t'i japë Fondit çdo tre muaj nga data e kësaj Marrëveshjeje, raporte periodike për ekzekutimin e Projektit dhe gjendjen e përgjithshme të Huasë, si dhe informacione të tjera që Fondi do të kërkojë në lidhje me Projektin dhe Huanë.

Huamarrësi dhe Fondi, kohë pas kohe, do të shkëmbejnë mendimet nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, përsa i përket çështjeve lidhur me qëllimin e Huasë dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të saj. Huamarrësi do të njoftojë Fondin, menjëherë, për çdo kusht që ndërhyr ose kërcënon të ndërhyjë në realizimin e qëllimeve të Huasë (duke përfshirë rritjen themelore në koston e Projektit) ose në mirëmbajtjen e shërbimeve të saj.

PARAGRAFI 4.11 Huamarrësi do të marrë të gjitha masat që do të jenë të nevojshme për ekzekutimin e Projektit dhe nuk do të marrë ose nuk do të lejojë që të merret ndonjë veprim që pengon ose ndërhyr në ekzekutimin e Projektit ose në kryerjen e ndonjë nga klauzolat e kësaj Marrëveshjeje.

PARAGRAFI 4.12 Huamarrësi:

(a) përpara se të mbarojë Projekti, do të riparojë të gjitha linjat elektrike të dëmtuara dhe instalimet në mënyrë që të sigurohet furnizimi me energji të pandërprerë i stacioneve të ujitjes dhe hidrovoreve në zonën e Projektit;

(b) do të riparojë dhe mirëmbajë gjatë gjithë kohës rrugët rurale në zonën e Projektit në mënyrë që të kemi akses në zonën e Projektit;

(c) do të sigurojë qëndrueshmërinë e digave (veçanërisht atyre të vogla e të mesme si dhe rezervuarëve) në zonën e projektit gjatë të gjithë kohës, dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për të arritur objektivin e sipërpërmendur;

(d) do të hartojë dhe zhvillojë një kuadër ligjor dhe institucional për sigurinë e digave dhe të pajisë Fondin me një kopje të materialit të lartpërmendur;

(e) do të ndërtojë dhe mirëmbajë sistemet e kontrollit të prurjes;

(f) do të monitorojë periodikisht bilancin ujor në zonën e Projektit dhe do të sigurojë shpërndarjen e sasisë së nevojshme të ujit në këtë zonë.

PARAGRAFI 4.13 Huamarrësi do të vazhdojë të punësojë, deri në mbylljen e Projektit, një drejtor të Njesisë, eksperiencia dhe kualifikimi i të cilit gjatë gjithë kohës do të jetë i pranueshëm nga Fondi.

PARAGRAFI 4.14 Huamarrësi:

(a) do të sigurojë që Projekti të jetë funksional dhe të mirëmbahet, do të funksionojë dhe mirëmbahen veprat e artit dhe objektet e tjera që nuk përfshihen në Projekt por ndikojnë në të, në përputhje me praktikat inxhinierike, bujqësore, financiare dhe administrative.

(b) do të sigurojë që Njësia do të pajisë Fondin menjëherë pas ekzekutimit të Marrëveshjes, për rishikim dhe aprovim, me një kopje të Manualit të Shfrytëzimit, në të cilin jepen procedurat e detajuara për supervizionin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin, supervizionin dhe trajnimin e FSHPU-ve dhe SHPU-ve në zonën e Projektit.

PARAGRAFI 4.15 Huamarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në çdo kohë, për minimizimin e çdo efekti të dëmshëm për sa i përket ambientit në zonën e Projektit, efekt ky që mund të lindë si shkak i zbatimit të Projektit apo gjatë shfrytëzimit. Veçanërisht, Huamarrësi, me qëllim që të evitohet impaktet e dëmshme të rreshjeve të tepërta dhe depozitimeve të ngurta në rezervuare, kanale dhe shtrate lumenjsh, duhet të zhvillojë një politikë pyllëzimi të pjesës kodrinore dhe një kontroll të shfrytëzimit të kullotave.

PARAGRAFI 4.16 Huamarrësi duhet të zhvillojë, gjatë zbatimit të Projektit, një program trajnimi dhe aktivitete, bazuar në nevojat e përfituesve në zonën e Projektit, në të gjitha aspektet e menaxhimit të ujitjes dhe aplikimit të teknikave e metodave moderne. Njësia duhet të mbikqyrë zbatimin me efikasitet të programit të lartpërmendur. Gjithashtu, Njësia duhet të zhvillojë një program të përshtatshëm trajnimi për trajnimin e trajnuesve.

PARAGRAFI 4.17 Huamarrësi do të sigurojë që Njësia do të vazhdojë të funksionojë gjatë gjithë kohës, sipas rregullave dhe rregulloreve dhe të ketë fuqi të tillë që të drejtojë dhe administrojë për sa është e nevojshme, kryerjen me kujdes dhe efektivitet të Projektit dhe shfrytëzimin e mëtejshëm të tij.

Huamarrësi, nën dritën e një kooperimi të frytshëm dhe duke bindur të dyja palët, do të informojë Fondin për çdo veprim të propozuar, i cili do të ndikonte në natyrën ose ndërtimin e Njesisë, si dhe do t'i japë Fondit të gjitha rastet e mundshme përpara ndërmarrjes së një veprimi të tillë, për t'i rishikuar këto ndryshime së bashku me Huamarrësin për sa i takon më sipër.

PARAGRAFI 4.18 është qëllimi reciprok i Huamarrësit dhe i Fondit që asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të gëzojë ndonjë prioritet mbi Huanë, nëpërmjet të drejtës së krijuar mbi pasurinë shtetërore. Huamarrësi merr përsipër që, përveç rasteve kur Fondi do të bjerë dakord ndryshe, në qoftë se do të krijohet ndonjë lënie pengu në pasurinë e Huamarrësit, si siguri për borxhin e jashtëm, ky lloj pengu do të përdoret si siguri për pagimin e shumës kryesore të Huasë, të interesit

dhe të detyrimeve të tjera. Klauzolat e mëparshme të këtij Paragrafi nuk do të zbatohen në:

(i) ndonjë lënie pengu të krijuar në pasuri (prona) vetëm si siguri për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj prone;

(ii) ndonjë lënie pengu në mallrat tregtare për të siguruar një maturim borxhli jo më shumë se një vit pas datës në të cilën ajo ndodh, si dhe për ta paguar prej të ardhurave të shitjes së këtyre të ardhurave tregtare;

(iii) ndonjë lënie pengu e krijuar në drejtim të transaksioneve të bankës dhe të sigurimit të një maturimi të borxhit jo më shumë se një vit pas datës së dhënies.

Termi "pasuri" e Huamarrësit, siç është përdorur në këtë Paragraf, përfshin pasuritë e Huamarrësit ose të atij që ka të drejtë pronësie apo kontrolli nga Huamarrësi, ose nga ndonjë nënseksion politik, duke përfshirë Bankën Qendrore të Huamarrësit ose ndonjë institucion tjetër që kryen funksionet e Bankës. Termi "peng", përfshin lënien peng, detyrimet, privilegjet dhe prioritetet e çdo lloji.

PARAGRAFI 4.19 Shuma themelore, interesi dhe të gjitha detyrimet e tjera mbi Huanë do të paguhet pa zbritje dhe pa përfshirë taksat që janë në fuqi sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve faktike në territorin e tij ose që do të jenë në të ardhmen.

Paragrafi 4.20 Kjo Marrëveshje do të jetë e çliruar nga çdo taksë, tatim, kuotë e çdo lloji që do të vihen sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve faktike në territorin e tij gjithashtu Huamarrësi do të paguajë taksa, tatime e kuota të tilla, në qoftë se ka, sipas ligjeve të vendit ose vendeve me monedhën e të cilëve paguhet Huaja apo ligjeve në territoret e këtij apo këtyre vendeve.

PARAGRAFI 4.21 Shuma kryesore, interesi dhe detyrimet e tjera të Huasë do të paguhet të çliruara nga të gjitha kufizimet, duke përfshirë dhe kufizimet e këmbimit të vëna sipas ligjeve të Huamarrësit.

PARAGRAFI 4.22 Të gjitha dokumentet, korrespondencat dhe materialet e tjera të ngjashme të Fondit do të konsiderohen nga Huamarrësi si çështje sekrete. Huamarrësi do t'i akordojë Fondit imunitet të plotë nga censurimi dhe inspektimi i botimeve.

PARAGRAFI 4.23 Të gjitha pasuritë dhe të ardhurat e Fondit do të çlirohen nga konfiskimi dhe shtetëzimi.

## Neni 5 **Anulimi dhe pezullimi**

PARAGRAFI 5.01 Huamarrësi, me anë të njoftimit tek Fondi, mund të anullojë ndonjë shumë të Huasë, shumë të cilën ai nuk e ka tërhequr para një njoftimi të tillë. Huamarrësi nuk mund të anullojë ndonjë shumë të huasë për të cilën Fondi do të ketë filluar një bisedim të veçantë sipas Paragrafit 3.02 të kësaj Marrëveshjeje.

PARAGRAFI 5.02. Fondi nëpërmjet njoftimit tek Huamarrësi, mund të pezullojë pjesërisht ose tërësisht të drejtën e Huamarrësit për të tërhequr nga Huaja, në qoftë se ndodh dhe vazhdon ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme:

(a) Kur ndodh një gabim në pagesën e shumës kryesore, në interesat ose pagesat e tjera të kërkuara sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshje tjetër të Huasë midis Huamarrësit dhe Fondit.

(b) Kur ndodh ndonjë gabim në kryerjen e ndonjë marrëveshjeje ose kontrata nga ana e Huamarrësi brenda kësaj marrëveshjeje.

(c) Fondi do të pezullojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të tërhequr sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër të huasë midis Huamarrësit dhe Fondit për shkak të ndonjë gabimi nga ana e Huamarrësit.

(d) Fondi IDA-s i dislokuar për projektin do të anulohet apo pezullohet dhe Huamarrësi nuk ka siguruar ndonjë alternativë tjetër për financim dhe kohe të arsyeshme dhe kushte të pranueshme nga Fondi.

(e) Një situatë e jashtëzakonshme e cila do ta bëjë të pamundur Huadhënësin të plotësojë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes.



Për çdo ngjarje që ndodh pas datës së kësaj Marrëveshjeje dhe përpara datës efektive që do t'i japë të drejtë Fondit të pezullojë të drejtën e Huamarrësit për të bërë kërkesë dhe në qoftë se Marrëveshja është bërë efektive në datën që ka ndodhur ngjarja, Fondi ka të drejtë të pezullojë kërkesat nën Huanë njësoj sikur kjo ngjarje të ketë ndodhur pas datës efektive.

E drejta e Huamarrësit për të bërë kërkesa për Huanë do të vazhdojë të mbetet e pezulluar pjesërisht ose tërësisht, sipas rastit, përderisa ngjarja ose ngjarjet që shkaktuan një pezullim të tillë kanë pushuar së ekzistuari ose derisa Fondi do të njoftojë Huamarrësin që e drejta për të bërë kërkesë i është rikthyer; duke kuptuar që në rast të një njoftimi të tillë e drejta për të bërë kërkesë do të rikthehet vetëm pas përmbushjes së kushteve të specifikuar në një njoftim të tillë, dhe njoftime të tilla nuk do të ndikojnë ose dëmtojnë ndonjë të drejtë, fuqi ose ndihmë të Fondit kundrejt ndonjë ngjarjeje të mëparshme të përshkruara në këtë Paragraf.

PARAGRAFI 5.03 Në qoftë se do të ndodhë ndonjë ngjarje e specifikuar në pikën (a) të Paragrafit 5.02 dhe do të vazhdojë për një periudhë prej 30 - ditësh pas njoftimit të dhënë nga Fondi Huamarrësit, ose në qoftë se do të ndodhë një ngjarje e specifikuar në paragrafet (b), (c), (d) dhe (e) të paragrafit 5.02 dhe do të vazhdojë për një periudhë prej 60 - ditësh, atëherë në kohën pasuese në vazhdimësi, Fondi mund të deklarojë që shuma kryesore e Huasë të paguhet menjëherë dhe sipas një deklaratë të tillë, kjo shumë e Huasë do të paguhet menjëherë.

PARAGRAFI 5.04 Nëqoftëse (a) e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Huaja do të pezullohet për një periudhë 30 - ditëshe ose (b) në datën e specifikuar në Paragrafin 3.09 si data e mbylljes, një shumë e Huasë do të mbetet e patërhequr. Fondi nëpërmjet njoftimit tek Huamarrësi, mund t'i japë fund të drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqjen e kësaj shume. Me dhënien e këtij njoftimi kjo shumë e Huasë do të anulohet.

PARAGRAFI 5.05 Anullimet dhe pezullimet nga Fondi nuk do të zbatohen për shumat e Huasë për angazhimet e veçanta të nisura nga Fondi në pajtim me Paragrafin 3.02.

PARAGRAFI 5.06 Vetëm në rastet kur Fondi do të bjerë dakord ndryshe, çdo pezullim do të zbatohet proporcionalisht në disa pagesa të shumës së Huasë të bëra pas datës së këtij pezullimi.

PARAGRAFI 5.07 Megjithë ndonjë pezullim ose anulim, të gjitha klauzolat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe efektive, përveç si përcaktohet në këtë nen.

## Neni 6

### **Detyrimet e Marrëveshjes Pushimi i ushtrimit të të drejtave; arbitrazhi**

PARAGRAFI 6.01 Të drejtat dhe detyrimet e Fondit dhe Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë të vlefshme dhe të detyrueshme në përputhje me nenet e pandryshueshme të ligjeve lokale. As Huamarrësi dhe as Fondi nuk kanë të drejtën për të shpallur ndonjë kërkesë që sigurimi i kësaj Marrëveshjeje është i pavleshëm ose jo i detyrueshëm për ndonjë arsye.

PARAGRAFI 6.02 Vonesat në ushtrimin ose lënia pas dore për të ushtruar çdo të drejtë ose fuqi të secilës palë sipas kësaj Marrëveshjeje për ndonjë të metë do të dobësojë këtë të drejtë e fuqi, gjithashtu dhe pranimi në heshtje i kësaj të mete do të pengojë e dobësojë të drejtën, fuqinë e secilës palë përsa i përket të metave të tjera pasuese.

PARAGRAFI 6.03. Çdo debat midis palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga cilado palë kundrejt tjetrës do të vendoset me marrëveshjen e palëve dhe në rast dështimi të kësaj Marrëveshjeje, debati ose pretendimi do të paraqitet në arbitrazh nga një trup gjykues e parashikuar në paragrafin në vazhdim.

PARAGRAFI 6.04 Trupi i arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjykatës të caktuar si më poshtë:

- arbitri i parë do të caktohet nga Huamarrësi;
- arbitri i dytë do të caktohet nga Fondi; dhe
- arbitri i tretë (këtej e tutje i quajtur Arbitër), do të caktohet nga marrëveshja e palëve ose në qoftë se ato nuk do të jenë dakord, nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me kërkesën e secilës palë. Në qoftë se secila palë nuk do të caktojë një arbitër, atëherë ky arbitër do të caktohet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e ndonjërës prej palëve. Në rast se arbitri i caktuar sipas këtij Paragrafi, jep dorëheqjen, vdes ose s'është i aftë për të vepruar

do të caktohet një arbitër tjetër pasardhës në të njëjtën mënyrë siç u përshkrua më lart, i cili do të ketë të gjitha fuqitë dhe detyrat e arbitrit të parë.

Procedura gjyqësore e arbitrazhit mund të caktohet, sipas këtij Paragrafi, me njoftimin nga pala që cakton këtë procedurë, drejtuar palës tjetër. Ky njoftim do të përmbajë një deklaratë duke paraqitur natyrën e debatit ose pretendimit që paraqitet në arbitrazh, emrin e arbitrit të caktuar nga pala kundërshtare.

Brenda 30 ditëve pas dhënies së këtij njoftimi, pala akuzuese njofton palën tjetër për procedurat e arbitrimin dhe emrin e arbitrit të emëruar nga kjo palë.

Në qoftë se brenda 60 ditëve pas dhënies së këtij njoftimi palët nuk do të jenë dakord për zgjedhjen e një arbitri, ato mund të kërkojnë zgjedhje të Arbitrit, siç është përcaktuar në pjesën e parë të këtij paragrafi.

Trupi gjykues do të vendosë për kohën dhe vendin, siç do të fiksohet nga arbitri. Pra, Trupi Gjykues do të caktojë se ku dhe kur do të zhvillohet arbitrazhi.

Sipas neneve të këtij Paragrafi dhe përveç rasteve kur palët do të bien dakord ndryshe, Trupi Gjykues do të vendosë të gjitha çështjet që lidhen me kompetencat e tij si dhe do të vendosë procedurën. Këto vendime do të merren me shumicë votash. Trupi Gjykues do t'i thërrasë të gjitha palët për të dëgjuar dhe për të dhënë vendimin e Gjyqit me shkrim. Ky vendim mund të jepet edhe i gabuar prandaj një vendim i nënshkruar nga shumica e Trupit Gjykues do të përcaktojë vendimin e këtij trupi. Një kopje e vendimit do t'i transmetohet secilës palë. Çdo vendim i tillë i dhënë në përputhje me klauzolat e këtij Paragrafi do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët e kësaj Marrëveshjeje. Çdo palë duhet të zbatojë këtë vendim të Trupit Gjykues.

Palët do të fiksojnë shumën e kuotës së arbitrazhit dhe të personave të tjerë që do të kërkojnë për drejtimin e procedurës së arbitrazhit. Në se palët nuk bien dakord për një shumë të tillë para vendimit të Trupit Gjykues, atëherë Trupi Gjykues do të fiksojë këtë shumë sipas kushteve. Secila palë do të paguajë shpenzimet e veta në procedurën gjyqësore të arbitrazhit. Shpenzimet e Trupit Gjykues do të ndahen midis dhe në mënyrë të barabartë nga palët. Çdo problem i lidhur me ndarjen e shpenzimeve të trupit gjykues ose me procedurën për pagesën e këtyre shpenzimeve, do të caktohet nga Trupi Gjykues.

Trupi Gjykues do të zbatojë parimet e përgjithshme sipas ligjeve në fuqi të Huamarrësit dhe shtetit të Kuvajtit, si dhe parimet e drejtësisë.

**PARAGRAFI 6.05** Klauzolat për arbitrazhin e paraqitur në Paragrafin e mëparshëm, do të jenë të vlefshme për çdo procedurë tjetër, për përcaktimin e debateve midis palëve të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të çdo pretendimi të secilës palë ngritur kundrejt palës tjetër.

**PARAGRAFI 6.06.** Shërbimi i çdo njoftimi ose procesi në lidhje me procedurat gjyqësore sipas këtij neni, mund të bëhet sipas mënyrës së cilësuar në Paragrafin 7.01. Palët në këtë Marrëveshje mund të heqin dorë nga kërkesat për shërbimin e një procesi ose njoftimi të tillë.

## Neni 7

### **Klauzola të ndryshme**

**PARAGRAFI 7.01** Çdo njoftim apo kërkesë e lejuar ose e kërkuar për t'u bërë sipas kësaj marrëveshjeje, do të jetë me shkrim. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafin 8.03, ky njoftim apo kërkesë do të gjykohet të bëhet në kohën e duhur kur ai do të dorëzohet dorazi ose me postë, teleks, telegram ose telefon në adresën e palës së specifikuar në këtë Marrëveshje ose në adresa të tjera që janë përcaktuar nga njoftimi i palës që e ka bërë këtë kërkesë ose ka dhënë këtë njoftim.

**PARAGRAFI 7.02** Huamarrësi do të pajisë Fondin me evidencat e nevojshme të autorizimit të personit ose personave përgjegjës të cilët do të firmosin kërkesën e parashikuar në nenin 3, ose të personit që në emër të Huamarrësit do të fillojë të veprojë, të plotësojë dokumentet e kërkuara apo të lejuara për t'u bërë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe firmat origjinale të secilit prej këtyre personave.

**PARAGRAFI 7.03** Çdo veprim i kërkuar apo i lejuar për t'u kryer, çdo dokument i kërkuar për t'i plotësuar sipas kërkesave të kësaj Marrëveshjeje, në emër të Huamarrësit, mund të kryhet

nga Ministri i Financës apo ndonjë person i autorizuar me shkrim nga ai. Çdo modifikim i klauzolave të kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet në emër të Huamarrësit nga përfaqësuesi i sipërpërmendur ose çdo person i autorizuar me shkrim nga ai, duke u siguruar që, sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, ky modifikim është arsyetuar sipas kushteve dhe në thelb nuk do të rrisë detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes. Fondi mund të pranojë kryerjen e veprimeve nga ky përfaqësues ose persona të tjerë, si dhe plotësimin e çdo dokumenti si përfundimtar që, sipas mendimit të tyre ky apo ai modifikim i klauzolave të Marrëveshjes është i arsyeshëm dhe ky plotësim nuk do të rrisë detyrimet e Huamarrësit.

## Neni 8

### **Data efektive: përfundimi**

PARAGRAFI 8.01 Fondi nuk do të jetë dakord me këtë Marrëveshje për ta bërë atë konkrete, derisa ai të jetë pajisur me evidencat e kënaqshme për të, që ekzekutimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes në emër të Huamarrësit është autorizuar dhe miratuar nga të gjitha instancat e nevojshme qeveritare.

PARAGRAFI 8.02 Si pjesë e evidencës që duhet siguruar në vijim të Paragrafit 8.01, Huamarrësi do t'i japë Fondit një opinion ose opinione të autoriteteve kompetente duke treguar që kjo Marrëveshje është autorizuar, miratuar në kohë dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe që është një detyrim i vlefshëm i Huamarrësit sipas kushteve të saj.

PARAGRAFI 8.03 Përveç rasteve kur Fondi dhe Huamarrësi bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe në veprim në datën në të cilën Fondi njofton me teleks Huamarrësin për pranimin e evidencave të kërkuara prej tij në Paragrafin 8.01.

PARAGRAFI 8.04 Në qoftë se të gjitha veprimet e kërkuara për t'u kryer sipas Paragrafit 8.01, nuk do të jenë përfunduar para 90 (nëntëdhjetë) ditëve pasi të jetë nënshkruar kjo Marrëveshje ose në ndonjë datë tjetër që do të bien dakord Fondi dhe Huamarrësi, Fondi do t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet lajmërimit të Huamarrësit. Pas dhënies së këtij njoftimi, kjo Marrëveshje dhe gjithë detyrimet e palëve do të përfundojnë menjëherë.

PARAGRAFI 8.05 Në qoftë se dhe kur shuma kryesore e Huasë, interesi dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga Huaja do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe gjithë detyrimet e palëve do të marrin fund menjëherë.

## Neni 9

### **Konkluzionet**

PARAGRAFI 9.01 Përveç rasteve kur kërkohet ndryshe, termat që vijojnë kanë kuptimet e mëposhtme, kudo ku janë përdorur në këtë Marrëveshje ose listë:

(1) Termi "Projekt" do të thotë: projekt ose projekte, program ose programe për të cilat jepet Huaja, siç përshkruhet në Listën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe përshkrimi do të përmirësohet kohë pas kohe sipas Marrëveshjes midis Fondit dhe Huamarrësit.

(2) Termi "mallra" do të thotë pajisje e shërbime të cilat kërkohen në Projekt. Kudo që është bërë referimi për koston e çdo malli, kjo kosto do të gjykohet duke përfshirë koston e importit të këtyre mallrave në territoret e Huamarrësit.

(3) Termi "përfitues" Federatat e Shoqatave të Përdoruesve të Ujit (FSHPU) dhe Shoqatat e Përdoruesve të Ujit (SHPU), të cilat do të marrin pjesë në zbatimin e projektit të ujitjes në rrethet përkatëse dhe do të shfrytëzojnë dhe mirëmbajnë veprat ujitëse në këto rrethe.

(4) Termi "Njësi" i referohet Njësisë së Zbatimit të Projektit të krijuar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit sipas rregullores së datës 5 prill 1999.

Adresat që pasojnë janë dhënë për qëllime të Paragrafit 7.01

Për Republikën e Shqipërisë:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë, Shqipëri

Adresa alternative me telefon dhe teleks:

TelefonTeleksFaks  
.....00355 42 28405  
00355 42 29200  
Për Fondin:  
Fondi Kuvajtian për Zhvillim Ekonomik Arab  
P.O.Box 2921, Safat  
Kuwait -13030

Adresa alternative me telefon dhe teleks:

TelefonTeleks Faks  
Alsunduk22025 Alsunduk00965 2419091  
Kuwait22613 Kfaed Kt00965 2436289

Në prani të dëshmitarëve, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, e firmosën këtë Marrëveshje me emrat përkatës dhe e dorëzuan në Tiranë, në tre kopje, e konsideruar secila si origjinali, me të njëjtin efekt për sa i përket ditës dhe vitit të shkruar më sipër.

Republika e Shqipërisë

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

Nga Anastas Angjeli  
(Përfaqësuesi i autorizuar)  
Ministër i Financave

Nga Abdulwahab Al-Bader  
(Përfaqësuesi i autorizuar)  
Zëvendësdrejtori i përgjithshëm

## LISTA 1 KLAUZOLAT E SHLYERJES

Shuma totale e Huasë do të shlyhet në 36 këste gjashtëmujore, shuma dhe procedurat janë dhënë në listën e bashkëngjitur. Kësti i parë do të paguhet datën e parë kur interesat dhe detyra të tjera mbi Huanë do të bëhen efektive, në përputhje me klauzolat e Marrëveshjes së Huasë, pas një periudhe kohore ekstra 4 - vjeçare, duke filluar që nga data kur Fondi paguan çdo shumë në vijim të kërkesës së parë për tërheqje të bërë nga Huamarrësi ose nga data në të cilën Fondi ndërmerr një veprim në përputhje me Paragrafin 3.02 të Marrëveshjes së Huasë, në rast se kërkohet ndërmarrja e një veprimi të tilli, cilado datë të jetë më e hershme se tjetra. Këstet e mbetura të shlyerjes do të paguhet në mënyrë të vazhdueshme, çdo gjashtëmujor, pas datës kur kësti i parë bëhet efektiv.

## ANEKSI I LISTËS 1 LISTA E AMORTIZIMIT

Sl. Nr	Pagesa (E shprehur në Dinarë Kuvajtian)
1	97.000
2	97.000
3	97.000
4	97.000
5	97.000
6	97.000
7	97.000
8	97.000
9	97.000
10	97.000
11	97.000

12	97.000
13	97.000
14	97.000
15	97.000
16	97.000
17	97.000
18	97.000
19	97.000
20	97.000
21	97.000
22	97.000
23	97.000
24	97.000
25	97.000
26	97.000
27	97.000
28	97.000
29	97.000
30	97.000
31	97.000
32	97.000
33	97.000
34	97.000
35	97.000
36	97.000
Total	3.500.000

Dinarë Kuvajtian tre milion e pesëqind mijë.

## LISTA 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti është një pjesë e programit të zhvillimit, i cili nisi në vitin 1993, dhe me qëllim rehabilitimin e skemave të ujitjes dhe kullimit në Shqipëri. Projekti synon të përmirësojë standardin e jetesës së fermerëve në zonën e Projektit dhe të forcojë ekonominë e vendit nëpërmjet rritjes së prodhimit bujqësor në shtatë rrethe: Vlorë, Elbasan, Lezhë, Korçë, Berat, Shkodër e Peqin. Projekti do të rehabilitojë 8 skema ujitjeje dhe kullimi në rrethet e lartpërmendura.

Projekti do të ketë këto komponentë kryesore:

1. Rehabilitimin e 8 skemave ujitëse dhe kulluese që mbulojnë një sipërfaqe prej 24,231 ha dhe sigurimin e të gjitha pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit për stacionet e pompave, së bashku me të gjitha pajisjet ndihmëse.

2. Mbështetje financiare nëpërmjet asistencës teknike, trajnimit dhe sigurimit të pajisjeve për:

- formimin dhe funksionimin e SHPU-ve dhe FSHPU-ve;
- mbështetjen për ristrukturimin e drejtorive të ujrave;
- zhvillimin e praktikave të përshtatshme të kontraktimit.

3. Asistencë teknike për: përmirësimin e projekteve të ujitjes dhe kullimit të veprave dhe pajisjeve të stacioneve, hartimin e Manualit të Shfrytëzimit, kryerjen e inspektimit në lidhje me sigurinë e digave, studime teknike dhe për ruajtjen e ambientit.

4. Mbështetje njësisë së Projektit nëpërmjet sigurimit të asistencës teknike në fushën inxhinierike, menaxhimit të ujit, menaxhimit financiar dhe prokurimit të mallrave. Gjithashtu, Projekti do të mbështesë rritjen e pagesave për stafin dhe sigurimin e mjeteve dhe bazës teknike.

5. Shërbime inxhinierike për projektimin dhe supervizionin e punimeve të Projektit.

Projekti ka filluar në mes të vitit 1999 dhe pritet të mbarojë në 30 qershor 2002.

## LETËR NR.1

Republika e Shqipërisë

Data 5.2.2001

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

P.O.Box 2921, Safat

Kuvajt, 13030

Të dashur zotërinj,

Subjekti: Lista e mallrave për t'u financuar nga Huaja

- Procedura për prokurim

Duke iu referuar paragrafeve 3.06 dhe 4.07 të Marrëveshjes së Kredisë lidhur me Projektin e Dytë të Rehabilitimit të Ujitjes (Faza II), që është firmosur sot midis Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab dhe Shqipërisë, ne konfirmojmë që të ardhurat nga Huaja do të shpërndahen për financimin e mallrave dhe shërbimeve sipas listës së bashkëngjitur në përqindjet dhe shumat e përmendura këtu, të cilat kohë më pas kohe mund të përmirësohen me aprovimin e Fondit, duke parashikuar që këto rregullime nuk do të rrisin shumën e Huasë.

Ne, gjithashtu, konfirmojmë që asnjë e ardhur e Huasë nuk do të përdoret për pagesat e taksave e detyrimeve të imponuara nga ligjet në fuqi të Shqipërisë.

Ne, gjithashtu, konfirmojmë se kontratat për pajisje dhe pjesë këmbimi do të financohen nga Huaja, për shuma që kalojnë vlerën prej 25 000 Dinarë Kuvajtian do të prokurohen, përveç rasteve ku është rënë dakord ndryshe, nëpërmjet tenderit internacional. Për shuma më të vogla se 25,000 Dinarë Kuvajtian mund të prokurohet edhe me tenderim të drejtpërdrejtë nga ndonjë numër furnizuesish apo prodhuesish të përshtatshëm për këto lloj pajisjesh, me kusht që vlera agregate e këtyre zërave që do prokurohen në mënyrë të tillë mos kalojë shumën ekuivalente me 300,000 Dinarë Kuvajtian.

Fondi konfirmon se, përderisa nuk do të bihet dakord ndryshe, prokurimi i të gjitha zërave të punimeve që do të financohen nga Huaja do të vazhdojë të kryhet mbi bazë të tenderimit lokal në përputhje me procedurat e prokurimit të pranueshme nga Fondi.

Përsa i përket zbatimit të Paragrafit 4.07 të referuar më sipër, prokurimit të zërave që do të financohen nga Huaja, ne do t'ju pajisim me një kopje të dokumenteve të tenderit për të gjitha vlerat, që do të kalojnë shumën ekuivalente me 25,000 Dollarë Kuvajtianë në avancë, me qëllim që të shqyrtohet, komentohet dhe të bëhen modifikime të tilla sa mund të kërkohen nga ju në këto dokumente ose në procedurën e ofertës. Pas marrjes dhe analizës së ofertave, ne do t'ju pajisim me një raport të hollësishëm të vlerësimit të ofertave, bashkë me rekomandimin për fituesin për mendimin dhe miratimin tuaj. Gjithashtu, çdo modifikim që do të propozohet për t'u bërë në lidhje me kushtet e ndonjë kontrate para ose pas lidhjes do të paraqiten për miratimin tuaj.

Në vazhdim të nënshkrimit të kontratave, ne do t'ju pajisim me kopjet që konfirmojnë nënshkrimin e tyre për efekt dokumentacioni dhe shpenzim nga Huaja lidhur me to.

Me qëllim që të sigurohet në kohë nënshkrimi i kontratave për ekzekutimin e Projektit, do të përpilohet një program për fazat e tenderimit, vlerësimit të ofertave, nënshkrimit të kontratave të mëdha dhe ne të do të ndërmerim të gjitha hapat e nevojshme për t'ju përmbajtur këtij programi si dhe do t'ju pajisim me një kopje të tij.

Lutemi, konfirmoni se jeni dakord për sa më sipër dhe për "Listën e mallrave të bashkëngjitur", duke nënshkruar formularin e konfirmimit në kopjen e mbyllur me këtë letër dhe duke na e kthyer atë.

Republika e Shqipërisë

Nga Anastas Angjeli

(Përfaqësuesi i Autorizuar)

Ministër i Financave

Konfirmuar:

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

Nga Abdul wahab Al-Bader

(Përfaqësuesi i Autorizuar)  
Zv/drejtor i përgjithshëm

Lista e mallrave

Nr	Emërtimi	Caktimi i Çmimit (në Dinarë Kuvajtianë)	Përqindja e kostos totale
1	Punime civile në ujitje dhe kullim	2 700 000	100%
2	Pajisje pompash dhe pjesë këmbimi	300 000	100%
3	Kontigjent fizik	500 000	
	SHUMA	3 500 000	

**L I G J**  
**Nr. 8820, datë 27.9.2001**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN “SHPËRNDARJA E SHËRBIMEVE SOCIALE””**

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1, 2 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë të zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Shpërndarja e shërbimeve sociale””.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3115, datë 3.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

Numri i Kredisë 3513 Shqipëri

**MARRËVESHJA**  
**E KREDISË SË ZHVILLIMITNDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS**  
**NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIMPROJEKTI I SHPËRNDARJES SË SHËRBIMEVE**  
**SOCIALE**

DATË 3 KORRIK, 2001

MARRËVESHJA e datës 3.7.2001, ndërmjet REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Huamarrësi) dhe SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (Shoqata).

Ndërsa, (A) Huamarrësi, pasi ka mbetur i kënaqur me zbatueshmërinë dhe prioritetin e projektit që përshkruhet në Seksionin 2 të kësaj Marrëveshjeje i ka kërkuar Shoqatës ta ndihmojë në financimin e këtij Projekti;

(B) Huamarrësi do të marrë financime grant nga Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Britanisë së Madhe për shumën dy milionë e pesëqind mijë dollarë (\$ 2,500,000) Grant i DFID-it për të ndihmuar në financimin e Pjesëve A.2, B dhe C.2 të Projektit sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në një marrëveshje që do të firmoset midis Huamarrësit dhe DFID (Marrëveshja e Grantit me DFID-in);

Ndërsa Shoqata midis të tjerash ka rënë dakord mbi bazën e sa më sipër t'i japë një Kredi Huamarrësit mbi bazën e afateve kohore dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

Në bazë të sa më sipër, palët e mësipërme bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

**Kushtet e Përgjithshme; përkufizimet**

Seksioni 1.01. “Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjeve të Kredisë së Zhvillimit” të Shoqatës të datës 1 janar, 1985 (siç janë ndryshuar deri më 6 tetor 1999) me modifikimet e mëposhtme (Kushtet e Përgjithshme) përbëjnë një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

(a) Një paragraf i ri (12) i shtohet Seksionit 2.01 me përmbajtjen e mëposhtme dhe për pasojë paragrafëve ekzistues (12) deri në (14) të këtij Seksioni do t'u vendosen numra të rinj dhe do të bëhen paragrafet (13) deri në (15);

“12. “Vend Pjesëmarrës” do të thotë çdo vend që për Shoqatën përmbush kushtet e përcaktuara në Seksionin 11 të Rezolutës nr.194 të Bordit të Guvernatorëve të Shoqatës së aprovuar më 8 prill 1999; dhe “Vendet Pjesëmarrëse” do të quhen me një emër (së bashku) të gjitha këto vende”; dhe

(b) Fjalja e dytë e Seksionit 5.01 është ndryshuar me përmbajtjen e mëposhtme:

“ Me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord të veprojnë ndryshe, nuk do të bëhet asnjë tërheqje: (a) për shpenzime në territorin e një vendi që nuk është Vend Pjesëmarrës apo për mallra të prodhuara dhe shërbime të siguruar nga këto teritore; ose (b) për qëllime pagesash të çfarëdo lloji përkundrejt personave apo njësive, apo për import mallrash, në rast se kjo pagesë apo ky import, me sa është në dijeni Shoqata, është i ndaluar me një vendim të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara sipas Kapitullit VII të Kartës të Kombeve të Bashkuara.”

Seksioni 1.02. Vetëm në ato raste kur kërkohet ndryshe nga konteksti, afatet e përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara më poshtë:

(a) “Përfitues” do të thotë çdo komunitet, organizatë apo agjenci e zgjedhur për të përfitur asistencë në kontekstin e Projektit;

(b) “Kategoritë e përzgjedhura” janë kategoritë nga (1) deri në (4) të përcaktuara në tabelën e Pjesës A.1 të Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje;

(c) “Shpenzime legjitime” janë shpenzimet për mallra dhe shërbime të cilave iu referohet Seksioni 2.02 i kësaj Marrëveshjeje;

(d) “APNSHS” do të thotë Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, e cila është agjenci që funksionon brenda Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Huamarrësit;



(e) “Agjencia zbatuese” ka kuptimin e çdo organizate apo agjencie me bazë komuniteti e evidentuar nga një përfitues për të qenë përgjegjës për zbatimin e një nënprojekti në emër të një Përfituesi;

(f) “Mis” do të thotë Sistemi i Menaxhimit të Informacionit dhe përfshin një “software” të vendosur/caktuar nga Huamarrësi për të siguruar të dhënat aktuale për treguesit e monitorimit të projektit dhe ecurinë në zbatimin e Projektit;

(g) “Manuali i punës” ka kuptimin e manualit, të kënaqshëm për shoqatën, ku përcaktohen rregullat dhe procedurat për zbatimin e Projektit, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes për nënprojektet dhe sigurimin e granteve për shërbimet e përkujdesjes sociale me bazë komuniteti dhe funksionimin e PCU-së;

(h) “PCU-ja” është Njësia e Koordinimit të Projektit, ngritur dhe mbajtur nga Huamarrësi brenda APSH-së në përputhje me dispozitën e paragrafit 7 të Skedulit 4 të kësaj Marrëveshjeje për qëllimet e menaxhimit të Projektit.

(i) “Raport i menaxhimit të projektit” është çdo raport që përgatitet në përputhje me Seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(j) “Komisioni për aprovimet rajonale” është komisioni që të organizohet në çdo rajon pjesëmarrës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga çdo pushtet rajonal, komunitet përftuesish dhe shoqëria civile;

(l) “Llogaria Speciale” është llogaria e përmendur në Pjesën B të Skedulit I të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(m) “Nënprojekt” ka kuptimin e një sërë aktiviteteve që do të kryhen nga një Agjenci Zbatimi në përdorim të asistencës që i është dhënë në dispozicion Përftuesit.

## Neni 2 Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t’i huajë Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara apo të referuara në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, një shumë në monedha të ndryshme të barabarta me shtatë milion e nëntëqind mijë të Drejta Speciale tërheqjeje (SDR 7,900,000).

Seksioni 2.02. (a) Shuma e Kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Skedulit I të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose për shpenzimet që do të bëhen në rast se bie dakord Shoqata) për kosto të arsyeshme mallrash dhe shërbimesh që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga Kredia.

Seksioni 2.03. Data e Mbylljes së Kredisë do të jetë 31 mars 2008 ose ndonjë datë e mëvonshme që do të përcaktohet nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë Huamarrësin momentin e duhur për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi do t’i bëjë Shoqatës një pagesë të detyruar mbi shumën kryesore të Kredisë që nuk është tërhequr herë pas here në një shumë që do të përcaktohet nga Shoqata në datën, 30 qershor të çdo viti, por që nuk duhet të kalojë gjysëm për qind (1/2 e 1% për vit).

b) Shuma e detyruar do të rritet; (i) pas gjashtëdhjetë ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje (data e interesit) deri në datat respektive në të cilat do të tërhiqen ose anulohen nga Huamarrësi shumat nga Llogaria e Kredisë; dhe (ii) në shumën e caktuar në 30 qershor, menjëherë përpara datës së interesit dhe me shumën të tjera siç mund të caktohen herë pas here në bazë të paragrafit (a) më sipër. Shuma e caktuar më datë 30 qershor të çdo viti do të zbatohet që nga data tjetër e atij viti, datë kjo e përcaktuar në Seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Shuma e detyruar do të paguhet: (i) në vende të tilla që kërkon Shoqata brenda arsyes; (ii) pa kufizime të çdo lloji të vendosura në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e specifikuar në këtë Marrëveshjeje për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme apo në ndonjë monedhë apo monedha të tjera të përshtatshme që mund të caktohen ose përzgjidhen herë pas here sipas dispozitave të atij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi duhet t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi prej tre të katërtave të një për qind (3/4 e 1%) në vit mbi shumën principale të Kredisë së tërhequr dhe të papaguar herë pas here.

Seksioni 2.06. Shumat e detyrueshme dhe ato të shërbimit do të jenë të pagueshme çdo gjashtë muaj më 15 janar dhe 15 korrik të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) Në bazë të paragrafeve (b), (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të paguajë shumën principale të Kredisë me këste gjashtë mujore të pagueshme në çdo 15 janar dhe 15 korrik duke filuar nga 15 korrik 2011 dhe duke përfunduar më 15 janar 2001. Çdo këst duke përfshirë këstin e pagueshëm më 15 janar 2021 do të jetë një për qind (1%) e kësaj shume principale dhe çdo këst i mëvonshëm do të jetë dy për qind (2%) e kësaj shume principale.

(b) Kur (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë (GNP-ja) e Huamarrësit, siç është vendosur nga Shoqata do të ketë kaluar për tre vjet rresht një pas një nivelin e përcaktuar për vit nga Shoqata; dhe (ii) Banka do t'a konsiderojë Huamarrësin të vlefshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata mundet që pas rishikimit dhe aprovimit nga drejtorët rrezekutivë të Shoqatës dhe pas një periudhe konsiderimi nga ana e tyre të zhvillimit të ekonomisë të Huamarrësit, të modifikojë pagesën e kësteve në bazë të paragrafit (a) më sipër:

(A) duke i kërkuar Huamarrësit të shlyejë dyfishin e shumës të secilit prej këtyre kësteve që nuk janë bërë ende për t'u paguar deri kur të paguhet shuma principale e Kreditit; dhe

(B) duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë pagesën e shumës principale të Kredisë që nga data e parë e pagesës gjysmë vjetore për të cilën bëhet fjalë në paragrafin (a) më sipër, pas gjashtë apo më shumë muajsh pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin që kanë ndodhur ngjarjet e përcaktuara në paragrafin (b), duke patur parasysh që do të ketë një periudhë faljeje (grace period) prej një minimumi pesë vjetësh mbi këtë shlyerje të principalit.

(c) Nëse kërkohet nga Huamarrësit, Shoqata mund të rishikojë modifikimet e referuara në paragrafin (b) më sipër që të përfshijnë disa ose të gjitha rritjet në shumat e kësteve të tilla, pagesën e interesit në një tarifë vjetore të rënë dakord me Shoqatën mbi shumën principale të Kredisë të tërhequr herë pas here, duke patur parasysh që në bazë të gjykimit të Shoqatës një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit që është marrë në bazë të modifikimit të mësipërm të shlyerjes.

(d) Nëse në ndonjë moment pas modifikimeve të termave në bazë të paragrafit (b) më sipër, Shoqata vendos që kushti ekonomik i Huamarrësit është përkeqësuar në mënyrë të ndjeshme, në rast se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mundet të modifikojë më tej termat e pagesës për të qenë konform skedulit të kësteve siç paraqitet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08. Për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme specifikohet monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

### Neni 3

#### Zbatimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit, të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të zbatojë Projektin me kujdesin/zellin dhe efikasitetin e duhur, si edhe në përputhje me praktikën e përshtatshme financiare, administrative, mjedisore dhe teknike. Huamarrësi do të sigurojë menjëherë, sipas nevojës, fondet, lehtësitë dhe burimet e tjera të kërkuara nga Projektin.

(b) Pa u kufizuar nga dispozitat e paragrafit (a) të këtij Seksioni dhe me përjashtim të atyre rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord për ndryshe, Huamarrësi do të zbatojë Projektin në përputhje me Programin e Zbatimit, të përcaktuar në Skedulit 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Me përjashtim të atyre rasteve kur Shoqata bie dakord për ndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulentëve që kërkohen në kuadrin e Projektit dhe që do të financohen nga Kredia do të qeverisen nga dispozitat e Skedulit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03. Për qëllimet e Seksionit 9.06 të Kushteve të Përgjithshme dhe pa u kufizuar me to, Huamarrësi:

(a) mbi bazën e udhëzimeve të pranueshme për Shoqatën, do të përgatisë dhe do t'i parqesë Shoqatës një plan për funksionimin e ardhshëm të Projektit jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes apo ndonjë date tjetër për të cilën mund të jetë rënë dakord midis Huamarrësit dhe Shoqatës; dhe

(b) do t'i japë Shoqatës mundësinë për të shkëmbyer mendime mbi këtë plan të Huamarrësit.

#### Neni 4

### Klauzolat financiare

Seksioni 4.01. (a) Huamarrësi do të mbajë një sistem të menaxhimit financiar, duke përfshirë regjistrat dhe llogaritë, si edhe do të përgatisë pasqyrat financiare në një format të pranueshëm për Shoqatën, i cili të jetë i përshtatshëm për të reflektuar veprimtarinë, burimet dhe shpenzimet e lidhura me Projektin.

(b) Huamarrësi:

(i) do të mbajë regjistrat, llogaritë dhe pasqyrat financiare të cilave u referohet paragrafi (a) i këtij seksioni, si edhe regjistrat dhe llogaritë për Llogarinë Speciale për çdo vit fiskal të audituar në përputhje me standardet e kontroll- revizionimit të pranueshme për Shoqatën, të aplikuara në mënyrë të qëndrueshme nga revizorë të pavarur të pranueshëm nga Shoqata;

(ii) do të paraqesë/dorëzojë Shoqatës (A) kopje të vërtetuara/certifikuara të pasqyrave financiare që u referohet paragrafi (a) i këtij Seksioni për çdo vit kontroll- revizioni dhe (B) një opinion mbi këto pasqyra, regjistra dhe raporte të kontroll- revizionit nga këta revizorë sipas detajeve të kërkuara, brenda arsyes nga Shoqata, sapo këto të jenë gati, por sidoqoftë jo më vonë se pas gjashtë muajsh nga data e përfundimit të çdo viti të tillë; dhe

(iii) do të paraqesë Shoqatës çfarëdolloj informacioni tjetër në lidhje me këto regjistra dhe llogari, si edhe me revizionimin e tyre, si edhe informacion në lidhje me revizorët sa herë që Shoqata ta kërkojë një gjë të tillë.

(c) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me tërheqjet nga Llogaria e Kredisë në bazë të deklaratës të shpenzimeve, Huamarrësi do të:

(i) do të mbajë apo do të shkaktojë mbajtjen e regjistrave dhe llogarive të veçanta që tregojnë këto shpenzime në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni;

(ii) do të ruajë për së paku një vit pasi Shoqata të ketë marrë raportin e kontroll-revizionit për vitin fiskal në të cilën është bërë tërheqja e fundit nga Llogaria e Kredisë, të gjitha regjistrat (kontratat, urdhrat, faturat dhe dokumentet e tjera) që vërtetojnë këto shpenzime;

(iii) do t'i vërë këto regjistra në dispozicion të përfaqësuesit të Shoqatës për shqyrtim; dhe

(iv) do të sigurohet që këto regjistra dhe llogari të përfshihen në kontroll-revizionin vjetor të cilit i referohet paragrafi (b) i këtij Seksioni dhe që raporti i këtij kontroll-revizioni të përmbajë një opinion të veçantë nga këta revizorë, nëse deklaratat e shpenzimeve gjatë vitit fiskal në fjalë, së bashku me procedurat dhe kontrollet e brendshme që janë bërë gjatë përgatitjes së tyre të jenë të besueshme për të mbështetur tërheqjet në fjalë.

Seksioni 4.02 (a) Pa u kufizuar në dispozitat e Seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të zbatojë një plan veprimesh me afate kohore që të jetë i pranueshëm për Shoqatën me synimin fuqizimin e sistemit të menaxhimit financiar që iu referuam në paragrafin (a) të Seksionit 4.01 në fjalë me qëllim që Huamarrësi, jo më vonë se data 30 shtator 2001 apo në atë datë të mëvonshme për të cilën do të bjerë dakord Shoqata për të përgatitur raporte tremujore, të pranueshëm për Shoqatën mbi menaxhimin e Projektit. Secili nga këta raporte:

(i) (A) përcakton burimet faktike dhe aplikimet për fondet e Projektit, si në mënyrë kumulative dhe për periudhën e mbuluar nga raporti në fjalë, si edhe burimet e parashikuara dhe aplikimet për fonde nga Projekti për periudhën gjashtëmujore pas periudhës të mbuluar nga raporti në fjalë, dhe (B) të tregojnë në veçanti shpenzimet e financuara nga Kredia gjatë periudhës që mbulon raporti në fjalë dhe shpenzimet e propozuara për t'u financuar nga Kredia gjatë gjashtë muajve pas periudhës të mbuluar nga raporti në fjalë;

(ii) (A) përshkruan progresin fizik në zbatimin e Projektit si në mënyrë kumulative, ashtu edhe për periudhën që mbulon raporti në fjalë dhe (B) shpjegon ndryshimet/mospërputhjet midis

synimeve faktike dhe atyre të parashikuara për zbatim; dhe

(iii) përcakton statusin e prokurimeve në kuadrin e Projektit dhe të shpenzimeve sipas kontratave të financuara nga Kredia në fund të periudhës të mbuluar nga raporti në fjalë.

(b) Me përfundimin e planit të veprimeve të përmendur në paragrafin (a) të këtij Seksioni, Huamarrësi në përputhje me udhëzime të pranueshme nga Shoqata do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Shoqatës jo më vonë se 45 ditë pas fundit kalendarik të çdo tremujori, një raport mbi Menaxhimin e Projektit për periudhën në fjalë.

#### Neni 5

#### **Mjetet ligjore të Shoqatës**

Seksioni 5.01. Në bazë të Seksionit 6.02 (1) të Kushteve të Përgjithshme, specifikohet ngjarja tjetër e mëposhtme;

(a) Manuali i Punës do të ndryshohet, pezullohet, abrogohet, apo anulohet, si edhe mund të shtohen dispozita të tjera ligjore në mënyrë që të ndikojnë materialisht dhe ndryshe në opinionin e Shoqatës, zbatimin e Projektit.

(b) E drejta e Huamarrësit për të tërhequr nga Granti i DFID-it që i është dhënë Huamarrësit për financimin e Pjesëve A.2, B dhe C.2 të Projektit do të pezullohet, anulohet apo mbyllet, e tëra ose pjesërisht, sipas termave të Marrëveshjes së Grantit me DFID-in; gjithsesi, me kusht që dispozitat e këtij paragrafi të mos aplikohen nëse Huamarrësi e bind Shoqatën që: (i) ky pezullim, anulim apo kjo mbyllje nuk ka ardhur si rrjedhojë e faktit që Huamarrësi nuk ka arritur të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe (ii) fonde të mjaftueshme për Projektin janë në dispozicion të Huamarrësit nga burime të tjera mbi bazë të kushteve dhe termave, në përputhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02. Sipas Seksionit 7.01 (h) të Kushteve të Përgjithshme, specifikohen evenimentet shtesë të mëposhtme, d.m.th. që do të ndodhë evinimenti i specifikuar në Seksionin 5.01 të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 6

#### **Data e hyrjes në fuqi; përfundimi**

Seksioni 6.01. Ngjarja e mëposhtme specifikohet si kusht shtesë për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit brenda kuptimit të Seksionit 12.01 (b) të Kushteve të Përgjithshme, domethënë që Huamarrësi ka aprovuar alokimin e buxhetit të nevojshëm për zbatimin e vitit të parë të projektit.

Seksioni 6.02. Data nëntëdhjetë (90) ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje është specifikuar këtu më poshtë për qëllimet e Seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

#### Neni 7

#### **Përfaqësuesi i Huamarrësit; adresat**

Seksioni 7.01. Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e Seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme.

Për Huamarrësin:  
Ministria e Financave  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"  
Tiranë  
Shqipëri

Për Shoqatën:  
International Development Association  
1818 H Street, N.W  
Washington, D.C 20433  
United States of America

Adresa  
Washington.D.C

INDEVAS

Teleks  
248423 (MCI) ose  
64145 (MCI)

NË PRANI TË DËSHMITARËVE, palët e mësipërme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, kanë firmosur në emrat e tyre përkatës në Distriktin e Kolumbias në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas ditës dhe vitit që është shkruar më sipër.

SHQIPËRIA  
Nga Fatos Tarifa  
Ambasador

Përfaqësuesi i autorizuar  
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM  
Nga CHRISTIAN POORTMAN

SKEDULI I  
TËRHEQJET NGA KREDIA

A. Të përgjithshme

1. Tabela e mëposhtme përcakton Kategoritë e njësive që do të financohen nga Kredia, shpërndarjen e shumave të Kredisë për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për çdo njësi që do të financohen nga secila Kategori.

Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (shprehur në ekuivalent të SDR) <sup>1</sup>	% e shpenzimeve që do të financohen
(1) Punime		
(a) për pjesën C.1 të projektit	[1,740,000]	85%
(b) përveç pjesës C.1 të Projektit	(160,000)	75%
(2) Mallra		
(a) për pjesën C.1 të projektit	(1,500,000)	100% e shpenzimeve të huaja, 100% e shpenzimeve lokale (kostoja ex-factory) dhe 85% e shpenzimeve lokale për artikuj të tjerë të prokuruar në vend
(b) përveç pjesës C.1 të Projektit	320.000	

Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (shprehur në ekuivalent të SDR) <sup>2</sup>	% e shpenzimeve që do të financohen
(3) Shërbimet e konsulencës dhe trajnim		100%
(a) për pjesën C.1 të projektit	1,770,000	85%
(b) përveç pjesës C.1 të Projektit	1,220,000	75%
(4) kosto inkrementale operationale	790,000	
(5) të paalokuara	400,000	100% e shpenzimeve të huaja, 100% e shpenzimeve lokale (kostoja ex-factory) dhe 85% e shpenzimeve lokale për artikuj të tjerë të prokuruar në vend
Total	7,900,000	

2. Për qëllimet e këtij Skeduli:

(a) termi “shpenzime të huaja” ka kuptimin e shpenzimeve në monedhën e çdo vendi, përveç asaj të Huamarrësit për mallra apo shërbime të furnizuara nga territori i çdo vendi, me përjashtim të atij të Huamarrësit;

(b) termi “shpenzime lokale” ka kuptimin e shpenzimeve në monedhën e Huamarrësit apo për mallra ose shërbime të furnizuara nga territori i Huamarrësit;

<sup>1</sup> Shprehur në dollarë, por që do të konvertohen në SDR përpara ose gjatë negociatave.

<sup>2</sup> Shprehur në dollarë, por që do të konvertohen në SDR përpara ose gjatë negociatave.

(c) termi “kosto operacionale shitesë” ka kuptimin e kostove operacionale shitesë të PCU-së për llogari të zbatimit, menaxhimit dhe monitorimit të Projektit, duke përfshirë pagat e stafit të PCU-së, duke përjashtuar ata që janë nëpunës civilë, komunikim, mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të Projektit dhe pajisje zyre, trajnime dhe udhëtime studimore dhe shpenzimet për udhëtime në terren për stafin e APNSHS-së dhe MOLSA-s, lidhur me zbatimin dhe monitorimin e Projektit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për:

(a) pagesa për shpenzime përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(b) pagesa për shpenzime në Kategorinë (3) (b) për shërbime të konsulentëve dhe trajnime, n.q.s. nuk ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Grantit me DFID-në.

4. Shoqata mund të kërkojë që tërheqjet nga Llogaria e Kredisë të bëhen në bazë të deklaratave të shpenzimeve për shpenzime, në lidhje me: (i) mallra sipas kontratave që kushtojnë nën USD 50.000; (ii) punime sipas kontratave që kushtojnë më pak se USD 75.000; (iii) shërbime sipas kontratave që kushtojnë më pak se USD 50,000; dhe (iv) kosto inkrementale operacionale sipas termave dhe kushteve që Shoqata do t’ia njoftojë specifikisht Huamarrësit.

#### B. Llogaria speciale

1. Huamarrësi do të hapë dhe mbajë një llogari të veçantë në dollarë, sipas kushteve të pranuar nga Shoqata, përfshirë mbrojtjen e duhur ndaj kompensimit, sekuestrimit dhe konfiskimit.

2. Pasi Shoqata të jetë informuar se Llogaria Speciale është hapur, tërheqjet nga Llogaria e Kreditimit të shumave që do të depozitohen në Llogarinë Speciale do të bëhen si më poshtë:

(a) derisa Shoqata të ketë marrë (i) raportin e parë të Menaxhimit të Projektit të përmendur në Seksionin 4.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje dhe (ii) një kërkesë nga Huamarrësi për tërheqje në bazë të raporteve të Menaxhimit të Projektit, tërheqjet do të bëhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës A të Skedulit 1; dhe

(b) me marrjen nga Shoqata të një Raporti të Menaxhimit të Projektit në bazë të Seksionit 4.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje, të shoqëruar me një kërkesë nga Huamarrësi për tërheqje në bazë të Raporteve të Menaxhimit të Projektit, të gjitha tërheqjet e mëtejshme do të bëhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës B të Skedulit 1.

3. Pagesat nëpërmjet Llogarisë Speciale do të bëhen ekskluzivisht për shpenzime të pranueshme/legjitime. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi nëpërmjet Llogarisë Speciale, Huamarrësi duhet që, në kohën që do ta kërkojë Shoqata në mënyrë të arsyeshme, t’i paraqesë Shoqatës të gjithë dokumentacionin dhe evidenca të tjera që tregojnë se kjo pagesë është bërë ekskluzivisht për shpenzime të pranueshme/legjitime.

4. Megjithë dispozitat e Pjesës B.2 të këtij Skeduli, Shoqatës nuk do t’i kërkohej të bëjë depozita të tjera në Llogarinë Speciale:

(a) në rast se Shoqata vendos në çdo kohë se Raporti i Menaxhimit të Projektit nuk jep informacionin e duhur të kërkuar në zbatim të Seksionit 4.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) në rast se Shoqata vendos në çdo kohë se të gjitha tërheqjet e mëtejshme duhen të bëhen nga Huamarrësi drejtpërdrejt nga Llogaria e Kreditit; ose

(c) në rast se Huamarrësi nuk do t’i ketë dhënë Shoqatës, brenda periudhës së specifikuar në Seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë pjesë të raporteve të kontrollit financiar të kërkuara për t’iu dhënë Shoqatës në zbatim të Seksionit të përmendur, në lidhje me kontrollin financiar të (A) rakordimeve dhe llogarive për Llogarinë Speciale ose (B) rakordimeve dhe llogarive që pasqyrojnë shpenzimet, në lidhje me të cilat u bënë tërheqjet në bazë të Raporteve të Menaxhimit të Projektit.

5. Shoqatës nuk do t’i kërkohej të bëjë depozitime të tjera në Llogarinë Speciale, sipas dispozitave të Pjesës B.2 të këtij Skeduli në rast se, në çdo kohë, Shoqata do të ketë njoftuar Huamarrësin për qëllimin e saj për pezullimin, plotësisht ose pjesërisht, të së drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Kreditit në zbatim të Seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme. Pas këtij njoftimi, Shoqata do të vendosë, nën arsyetimin e vetëm të saj, nëse mund të bëhen depozitime të tjera në Llogarinë Speciale dhe çfarë procedurash duhen ndjekur për t’i bërë depozitime dhe për këtë vendim njofton Huamarrësin.

6. (a) Në rast se Shoqata vendos, në çdo kohë, se një pagesë nga Llogaria Speciale është bërë për një shpenzim që nuk është shpenzim legjitim/i pranueshëm ose nuk ishte i justifikuar në

bazë të evidencave të dhëna nga Shoqata, Huamarrësi duhet që, menjëherë sapo merr njoftimin e Shoqatës, të paraqesë dokumentet shtesë që mund të kërkohen nga Shoqata ose të depozitohet në Llogarinë Speciale (ose, në rast se kërkohet nga Shoqata, të rifinancojë Shoqatën) me një shumë të barabartë shumën e kësaj pagese. Në rast se Shoqata nuk bie dakord ndryshe, në Llogarinë Speciale nuk bëhet

asnjë depozitim tjetër nga Shoqata, deri sa Huamarrësi t'i ketë paraqitur këto dokumente ose të ketë bërë këtë depozitim ose rifinancim sipas rastit.

(b) Në rast se Shoqata vendos, në çdo kohë, të mos kërkohet një shumë e zbuluar në Llogarinë Speciale për të mbuluar pagesat për shpenzime të pranueshme gjatë periudhës gjashtë-mujore pas këtij vendimi, Huamarrësi duhet që, menjëherë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shoqata, të rifinancojë Shoqatën me këtë shumë të zbuluar.

(c) Duke njoftuar Shoqatën, Huamarrësi mund ta rifinancojë Shoqatën me të gjitha ose një pjesë të fondeve të depozitara në Llogarinë Speciale.

(d) Rifinancimet për Shoqatën, në zbatim të nënparagrafeve (a), (b) ose (c) të këtij paragrafi 6, do t'i kreditohen Llogarisë së Kreditimit për tërheqje të mëpasme ose për anulim në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit.

## ANEKSI A

i

### SKEDULIT 1

#### VEPRIMET ME LLOGARINË E VEÇANTË KUR TËRHEQJET NUK BËHEN NË BAZË TË RAPORTEVE TË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT

##### 1. Për qëllimet e këtij Aneksi:

(a) termi “Shumë e Autorizuar” do të thotë një shumë e barasvlefshme me \$500,000 që duhet të tërhiqet nga Llogaria e Kreditimit dhe do të depozitohet në Llogarinë Speciale në zbatim të paragrafit 2 të këtij Aneksi; sidoqoftë, me kusht që, në rast se Shoqata nuk bie dakord ndryshe, Shuma e Autorizuar do të kufizohet në shumën ekuivalente prej \$250,000 deri sa shuma agregate e tërheqjeve nga Llogaria e Kreditimit, plus shumën e përgjithshme e të gjitha angazhimeve të veçanta të mbetura në të cilat ka hyrë Shoqata në zbatim të Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme të jetë e barabartë me ekuivalentin prej SDR 2,500,000.

2. Tërheqjet nga Shuma e Autorizuar e Llogarisë së Veçantë dhe tërheqjet e mëpasme për të plotësuar Llogarinë Speciale do të bëhen si më poshtë:

(a) Për tërheqjet e shumës së Autorizuar nga Llogaria Speciale, Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës një kërkesë ose disa kërkesa për depozitim në Llogarinë Speciale të një shume ose shumave të cilat, në total, nuk e kalojnë Shumën e Autorizuar. Në bazë të çdo kërkesë të tillë, Shoqata do të tërheqë, në emër të Huamarrësit, nga Llogaria e Kreditimit dhe do të depozitohet në Llogarinë Speciale atë shumë që do të ketë kërkuar Huamarrësi.

(b) Për plotësimin e Llogarisë Speciale, Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës kërkesa për depozitim në Llogarinë Speciale në ato intervale që mund të specifikohen nga Shoqata. Para ose në kohën e secilës prej këtyre kërkesave, Huamarrësi i paraqet Shoqatës dokumentacionin dhe evidencat e kërkuara në zbatim të Pjesës B.3 të Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje për pagesën ose pagesat në lidhje me të cilat kërkohet plotësim. Në bazë të secilës prej këtyre kërkesave, Shoqata do të tërheqë nga Llogaria e Kreditit, në emër të Huamarrësit, dhe depozitohet në Llogarinë Speciale atë shumë që mund të ketë kërkuar Huamarrësi dhe që do të jetë treguar në dokumentacionin dhe evidencat e mësipërme se janë paguar nga Llogaria Speciale për shpenzimet legjitime/të pranueshme. Secila prej këtyre derdhjeve në Llogarinë Speciale do të tërhiqet nga Shoqata nga Llogaria e Kredisë sipas një a më shumë kategorive legjitime/ të pranueshme të Llogarisë Speciale.

3. Shoqatës nuk do t'i kërkohet të bëjë derdhje të tjera në Llogarinë Speciale kur shuma e përgjithshme e patërhequr e Kreditit të caktuar për kategorinë legjitime/të pranueshme të Llogarisë Speciale minus shumën e përgjithshme të angazhimeve të veçanta të zbuluara, të lidhura nga Shoqata, në zbatim të Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme, do të jetë e barabartë me dyfishin e shumës së shumës së autorizuar të Llogarisë Speciale. Që këtej, tërheqja nga Llogaria e Kreditimit

e shumës së mbetur të patërhequr të Kreditit do të ndjekë ato procedura që do të specifikojë Shoqata dhe për të cilat do të njoftojë Huamarrësin. Këto tërheqje të mëtejshme do të bëhen vetëm pasi dhe në masën që Shoqata të jetë e kënaqur, se të gjitha ato shuma që kanë mbetur në depozitë në Llogarinë Speciale, që nga data e këtij njoftimi do të përdoren për bërjen e pagasave për shpenzime legjitime/të pranueshme.

## ANEKSI B

### SKEDULIT 1

#### VEPRIMET ME LLOGARINË SPECIALE

#### KUR TËRHEQJET BËHEN NË BAZË TË RAPORTEVE TË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT

1. Përveç rasteve kur specifkohet ndryshe nga Shoqata dhe njoftimit të Huamarrësit në lidhje me këtë, të gjitha tërheqjet nga Llogaria e Kreditimit do të depozitohen nga Shoqata në Llogarinë Speciale, në përputhje me dispozitat e Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje. Shoqata do të tërheqë çdo derdhje të tillë dhe në Llogarinë Speciale nga Llogaria e Kreditimit, sipas një a më shumë kategorive legjitime të pranueshme të Llogarisë Speciale.

2. Çdo kërkesë për tërheqje nga Llogaria e Kreditimit për depozitim në Llogarinë Speciale do të shoqërohet me një Raport të Menaxhimit të Projektit.

3. Me marrjen e kësaj kërkesë për tërheqje të një shume të Kredisë, Shoqata do të tërheqë, në emër të Huamarrësit, nga Llogaria e Kreditimit dhe do të depozitojë në Llogarinë Speciale një shumë të barabartë me më pak se: (a) shuma e kërkuar; dhe (b) shuma që ka përcaktuar Shoqata, bazuar në Raportin e Menaxhimit të Projektit, që shoqëron kërkesën e mësipërme, kërkohet të depozitohet me qëllim që të financohen shpenzimet legjitime gjatë periudhës gjashtëmuajore pas së këtij raporti; megjithatë, me kusht që shuma e depozituar, kur t'i shtohet shumës së treguar nga Raporti i mësipërm i Menaxhimit të Projektit që mbetet në Llogarinë Speciale të mos e kalojë ekuivalentin e \$ 500.000.

### SKEDULI 2

#### PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i Projektit është përmirësimi i standardeve të jetesës për të varfërit dhe grupet vulnerabël të Huamarrësit përmes: (i) rritjes së aksesit të tyre ndaj shërbimeve efikase të përkujdesjes sociale; dhe (ii) ndihmesës që do t'i jepet Huamarrësit për të zhvilluar politika efektive të përkujdesjes sociale dhe për të përmirësuar kapacitetin e Huamarrësit në shpërndarjen dhe monitorimin e shërbimeve të përkujdesjes sociale.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, gjithmonë të modifikueshme, në rast se Huamarrësi dhe Shoqata mund të bien dakord nga koha në kohë për të arritur këto objektiva:

#### Pjesa A. Zhvillimi i politikave

1. Sigurimi i pajisjeve, trajnimit dhe shërbimeve të konsulentëve për të mbështetur kuadrin institucional, si edhe për të zhvilluar kapacitetet e Huamarrësit në mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen në kohë të informacionit statistikor të përshtatshëm në nivel familjeje për monitorimin e varfërisë dhe vlerësimin e programeve sociale.

2. Sigurimi i trajnimit dhe shërbimeve të konsulencës për zhvillimin e kapacitetit të Huamarrësit në zhvillimin e politikave, duke përfshirë: (a) vendosjen e standardeve për shërbimet e përkujdesjes sociale dhe monitorimin e këtyre standardeve; (b) shpërndarjen e informacionit publik me qëllim propagandimin dhe hartimin e programeve "outreach" mbi problemet e përfshirjes sociale; (c) zhvillimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, si edhe përcaktimin e përgjegjësive për monitorimin dhe administrimin e shërbimeve të përkujdesjes sociale; (d) zhvillimin e një sistemi dhe kuadri të qëndrueshëm financiar për pjesëmarrjen dhe koordinimin e donatorëve në financimin e shërbimeve të përkujdesjes sociale me bazë komuniteti.

3. Sigurimi i shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit në mbështetje të përdorimit efektiv të mjeteve/instrumenteve aktuale për modelimin e politikës së pensioneve dhe vlerësimin e varianteve të mundshme për reformën.

#### Pjesa B. Monitorimi dhe administrimi i shërbimeve sociale



1. Sigurimi i pajisjeve, shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të Huamarrësit për monitorimin dhe administrimin e shërbimeve sociale me bazë komuniteti.

2. Sigurimi i shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit për thellimin e kapacitetit të Huamarrësit për trajnimit për punën sociale, si edhe për zhvillimin e një sistemi për trajnim me baza të rregullta të punonjësve socialë në ofrimin e shërbimeve sociale me bazë komuniteti.

Pjesa C: Shërbime sociale me bazë komuniteti

1. Sigurimi i Granteve për nënprojekte, me qëllim krijimin e shërbimeve sociale me bazë komuniteti për grupet e synuara të popullatës mbi bazën e kriterëve të legjitimitetit/përshtatshmërisë të përcaktuara në Manualin e Punës (operacional), si edhe mbi bazën e procedurës dhe kriertereve për përzgjedhjen e nënprojekteve të vendosura në Skedulën 5 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Sigurimin e shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit për pushtetin lokal dhe ofruesit e shërbimeve me qëllim menaxhimin e shërbimeve sociale me bazë komuniteti, punën sociale dhe menaxhimin e rasteve.

Pjesa D: Menaxhimi dhe monitorimi i Projektit

Sigurimi i pajisjeve, trajnimit, shërbimeve të konsulencës dhe kostove inkrementale operacionale për t'i ardhur në ndihmë zbatimit efektiv të aktivitetëve të Projektit, si edhe zhvillimit të sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të informacionit të Projektit.

\*\*\*

Projekti është parashikuar të përfundojë më 30 shtator 2001.

### SKEDULI 3 PROKURIMET DHE SHËRBIMET E KONSULENCËS

Seksioni 1. Prokurimi i mallrave dhe punimeve

Pjesa A: Të përgjithshme

1. Mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me (a) dispozitat e Seksionit të materialit "Udhëzime për prokurimin sipas Huave të BERZH-it dhe Kredive të IDA-s", botuar nga Banka në janar 1995 dhe ripunuar në janar dhe gusht 1996, shtator 1997 dhe janar 1999 (Udhëzimet), si edhe dispozitat e pjesëve vijuese të këtij Seksioni I.

2. Në paragrafet 1.6 dhe 1.8 të Udhëzimeve, emërtimet "vendet anëtare të Bankës" dhe "vend anëtar" do të merren, përkatësisht, njësoj si emërtimet "vende pjesëmarrëse" dhe "vend pjesëmarrës".

Pjesa B. Tender konkurrues ndërkombëtar

1. Përveç asaj që parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, mallrat dhe punimet do të prokurohen, në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e Seksionit II të udhëzimeve dhe paragrafit 5 të Aneksit I të tyre.

2. Dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për mallrat dhe punimet që duhet të prokurohen, në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të kësaj Pjesë B.

a) Preferenca për mallra të prodhuara në vend dhe kontraktorë vendas.

Dispozitat e paragrafeve 2.54 dhe 2.55 të udhëzimeve dhe Aneksit 2 të tyre do të zbatohen për mallrat e prodhuar në territorin e Huamarrësit dhe për punimet që do të kryhen nga kontraktorë vendas.

Pjesa C: prodecura të tjera prokurimi

1. Tender konkurrues kombëtar

Mallrat që llogaritet se kushtojnë më pak se ekuivalenti \$ 100.000 për kontratë deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë ekuivalentin \$ 2,200 000, mund të blihen sipas kontratave të lidhura sipas dispozitave të paragrafeve 3,5 dhe 3,4 të udhëzimeve.

2. Blerja ndërkombëtare

Mallrat që llogaritet se kushtojnë më pak se ekuivalenti \$ 100,000 për kontratë deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë ekuivalentin \$ 100,000 mund të prokurohen sipas kontratave të lidhura në bazë të procedurave të blerjes ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat e paragrafeve 3.5 dhe 3.6 të udhëzimeve.

### 3. Blerjet kombëtare

Mallrat që llogaritet se kushtojnë më pak se ekuivalenti \$ 25.000 për kontratë, deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë ekuivalentin \$ 1.000.000 mund të blihen sipas kontratave të lidhura në bazë të procedurave të blerjes kombëtare, në përputhje me dispozitat 3.5 dhe 3.6 të udhëzimeve.

#### 4. Prokurimi nga agjenci të Kombeve të Bashkuara

Si alternativë për blerjen, prokurimi i mallrave mund të kryhet edhe përmes Zyrës së Shërbimeve të Prokurimit Ndëragjenci (IAPSO) të Programit për Zhvillim të Kombneve të Bashkuara (UNDP) në përputhje me paragrafin 3.9 të udhëzimeve.

#### 5. Prokurimi i punimeve të vogla

Punimet që mendohen të kushtojnë më pak se ekuivalenti i \$ 20.000 për kontratën deri në një shumë agregate që nuk duhet të kalojë ekuivalentin 500.000 mund të prokurohen përmes kontratave me një shumë të vetme (lump-sum) apo me çmim fiks të lidhura mbi bazën e kuotimeve nga tri (3) kontraktorë të kualifikuar vendas në përgjigje të një ftese me shkrim. Ftesa do të përmbajë një përshkrim të detajuar të punimeve, duke përfshirë specifikimet bazë, datën në të cilën kërkohet të mbarojë ky punim, një formular bazë marrëveshjeje të pranueshme për Shoqatën, si edhe skica të caktuara, në ato raste kur këto janë të aplikueshme. Kontrata do t'i jepet atij kontraktori i cili ofron kuotimin me çmimin më të ulët për punën që kërkohet dhe i cili ka eksperiencën dhe burimet për ta përfunduar me sukses kontratën.

#### Pjesa D. Rishikimi i vendimeve të prokurimeve nga Shoqata

##### 1. Planifikimi i prokurimit

Përpara dërgimit të ftesave për oferta për kontrata, plani i propozuar për prokurim për Projektin do t'i jepet Shoqatës për shqyrtim dhe aprovim, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të Apendiksit 1 të udhëzimeve. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe punimeve do të kryhet në përputhje me planin e prokurimeve të aprovuara nga Shoqata, si edhe me dispozitat e paragrafit 1.

##### 2. Shqyrtimi paraprak

(a) Në lidhje me secilën nga kontratat e Pjesës B, përsa i takon pesë kontratave të para në paragrafin 1 të Pjesës C dhe përsa i takon tri kontratave të para në paragrafin 5 të Pjesës C, do të zbatohen procedurat e përcaktuara në paragrafet 2 dhe 3 të Shtojcës I të Udhëzimeve.

(b) Përsa i takon tri kontratave të paragrafeve 2 dhe 3 të Pjesës B do të aplikohen procedurat e mëposhtme:

(i) përpara përzgjedhjes së çfarëdo furnitori sipas procedurave të blerjes (shopping), Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës një raport mbi krahasimin dhe vlerësimin e kuotimeve të marra;

(ii) përpara zbatimit të çfarëdo kontrate të prokuruar sipas procedurave të blerjes (shopping), Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës një kopje të specifikimeve dhe projekt-kontratës; dhe

(iii) do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafet 2 (f), 2(g) dhe 3 të Shtojcës 1 të udhëzimeve.

##### 3. Shqyrtimi i mëposhtëm

Procedurat e përcaktuara në paragrafin 4 të Shtojcës 1 do të zbatohen në lidhje me çdo kontratë që nuk udhëhiqet nga paragrafi 2 i kësaj Pjese.

#### Seksioni II. Punësimi i konsulentëve

##### Pjesa A: Të përgjithshme

1. Shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në përputhje me (a) dispozitat e Hyrjes dhe të Seksionit IV të materialit "Udhëzimet: Përzgjedhja dhe Pajtimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", botuar nga Organizata në janar 1997 dhe rishikuar në shtator 1997 dhe janar 1999, në varësi të ndryshimeve të bëra të përcaktuara në paragrafin 2 të kësaj Pjese A (Udhëzimet për Konsulentët) dhe (b) dispozitat e Pjesëve vijuese të këtij Seksioni II.

2. Në paragrafet 1.10 të Udhëzimeve për Konsulentët, emërimet "vende anëtare të Bankës" dhe "vend anëtar" do të merren, përkatësisht, njësoj si emërimet "vende pjesëmarrëse" dhe "vend pjesëmarrës".

##### Pjesa B: Përzgjedhja mbi bazën e cilësisë dhe kostos

Përveç asaj që parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, shërbimet e konsulentëve

do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e Seksionit II të Udhëzimeve për Konsulentët, paragrafi 3 i Shtojcës 1 të tyre, Shtojcës 2 të tyre dhe dispozitat e paragrafeve 3.13 deri në 3.18 të tyre të zbatueshme për përzgjedhjen e konsulentëve sipas cilësisë dhe kostos.

Pjesa C. Procedurat e tjera për përzgjedhjen e konsulentëve

1. Përzgjedhje mbi bazën e kualifikimit të konsulentëve

Shërbimet për hartimin e standardeve, planifikimit, ngritjen e kapaciteteve dhe administrimin e menaxhimit të rasteve pritet të kushtojnë më pak se ekuivalenti i \$ 100.000 për kontratë mund të prokurohen sipas kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafeve 3.1 dhe 3.7 të udhëzimeve për konsulentët.

2. Konsulentë individualë

Shërbimet për detyra që i plotësojnë kërkesat e parashikuara në paragrafin 5.1 të Udhëzimeve për Konsulentët, do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura me konsulentë të veçantë në përputhje me dispozitat e paragrafeve 5.1 deri në 5.3 të Udhëzimeve për Konsulentët.

Pjesa D: Shqyrtimi nga Shoqata i Përzgjedhjes së Konsulentëve

1. Planifikimi i përzgjedhjes

Përpara nxjerrjes të ndonjë kërkesë për propozime për konsulentët, plani i propozuar për përzgjedhjen e konsulentëve në bazë të Projektit do t'i paraqitet Shoqatës për kontrollin dhe miratimin e saj, sipas dispozitave të paragrafit 1 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët. Përzgjedhja e shërbimeve të konsulentëve do të ndërmerret në përputhje me planin e përzgjedhjes që do të miratohet nga Shoqata dhe me dispozitat e paragrafit 1 të përmendur.

2. Shqyrtimi paraprak

(a) Në lidhje me çdo kontratë për pajtimin e firmave të konsulentëve për pjesën B dhe paragrafin I të Pjesës C, do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafet 1,2 (dhe jo nënparagrafi i tretë i paragrafit 2(a) dhe 5 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët).

(b) Në lidhje me pesë kontratat e para për pajtimin e konsulentëve të veçantë për paragrafin 2 të Pjesës C, kualifikimet, përvoja termat e referencës dhe kushtet e pajtimit të konsulentëve do t'i paraqiten Shoqatës për rishikim dhe miratim paraprak. Kontrata do të lidhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i mësipërm.

3. Rishikimi më pas

Në lidhje me çdo kontratë që nuk qeveriset nga paragrafi 2 i kësaj Pjese do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafin 4 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

#### SKEDULI 4 PROGRAMI I ZBATIMIT

1. Huamarrësi:

(a) do të mbajë politikën dhe procedurat në mënyrë të tillë që të jetë i mundur monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i tyre, në përputhje me tregues të kënaqshëm për Shoqatën, zbatimin dhe arritjet e objektivave të tij.

(b) do të përgatisë, sipas Termave të Referencës të kënaqshme për Shoqatën, dhe do t'i paraqesë Shoqatës në datën 30 shtator 2004 ose rreth kësaj date, një raport ku të përfshihen rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit sipas paragrafit (a) të këtij Seksioni, në lidhje me progresin e arritur gjatë zbatimit të Projektit në periudhën përpara datës së këtij raporti dhe të caktojë masat e rekomanduara për të siguruar zbatimin efektiv të Projektit dhe arritjen e objektivave të caktuar gjatë periudhës pas kësaj date; dhe

(c) do të shqyrtojë me Shoqatën, deri më 31 dhjetor 2004, apo në ndonjë datë të mëvonshme që do të kërkohet nga Shoqata, raportin të cilit i referohet paragrafi (b) i këtij Seksioni dhe më pas të marrë të gjitha masat që kërkohen për të siguruar përfundimin efikas të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij mbi bazën e konkluzioneve dhe rekomandimeve të këtij raporti në fjalë, si edhe mbi mendimet/opinionin e Shoqatës në lidhje me çështjen.

2. Humarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës një program vjetor pune për projektin deri më datën 1 mars të çdo viti.

3. Huamarrësi:

(a) do të përfundojë një vlerësim të parë të përfituesve dhe do t'ia dërgojë Shoqatës deri më 31 dhjetor 2003 një raport për vlerësimin e impaktit të përfituesve; dhe

(b) do të kryejë një vlerësim të impaktit të përfituesve çdo 2 vjet dhe do t'ia dërgojë Shoqatës deri më 30 qershor të vitit në vazhdim një raport të vlerësimit të impaktit tek përfituesit.

4. Huamarrësi:

(a) do të përfundojë prokurimin e parë dhe auditimin teknik do t'ia paraqesë Shoqatës deri më 31 dhjetor 2004 raportin e prokurimit dhe auditimit teknik; dhe

(b) do të kryejë auditimin përfundimtar teknik dhe prokurimin dhe do t'ia paraqesë Shoqatës deri më 30 prill 2007.

5. Deri më 31 dhjetor 2001, Huamarrësi do t'i bëjë amendament vendimit nr.52, datë 8 gusht 1996 në lidhje me Administratën e Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, me qëllim për të ripërcaktuar rolin e APNSHS-së në monitorimin dhe administrimin e këtyre shërbimeve.

6. Huamarrësi, deri më datë 31 tetor 2001, duhet të ketë instaluar versionin e parë të "software"-it MIS.

7. Huamarrësi do të alokojë çdo vit fondet e kërkuara gjatë vitit fiskal për zbatimin e Projektit.

8. Deri në përfundimin e Projektit, Huamarrësi do të mbajë PCU-në me burime staf dhe terma reference të kënaqshme për Shoqatën.

## SKEDULI 5

### PROCEDURA DHE KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E NËNPROJEKTEVE

1. APNSHS-ja qendrore dhe PCU-ja do të përgjigjet për përzgjedhjen e propozimeve për nënprojekte.

2. Zyra rajonale e APSH-së do të fillojë fushatën e promovimit, ndjekur nga botimi i kërkesave për propozime për nënprojekte, në bashkëpunim me pushtetin rajonal për të ftuar bashkitë, sektorin privat dhe OJQ-të që sigurojnë shërbime sociale.

3. Aplikanti do të duhet të përmbushë kriteret e parapërzgjedhjes të përcaktuara në Manualin Operacional në lidhje me: (a) përputhshmërinë me kërkesat për dokumentacion; (b) grupet e përfituesve të synuar; (c) llojet e projekteve të përshtatshme për financim; dhe (d) shumën dhe bashkëfinancimin. Kontributi i pushtetit lokal do të jetë së paku 10% të kostos së investimit dhe 100% të kostos korrente të nënprojektit.

4. Zyra rajonale e APSH-së do të vlerësojë propozimet mbi bazën e sa më poshtë: (a) ndikimin e tij në shoqëri; (b) kapaciteti institucional për zbatimin e shërbimeve të parashikuara nga granti; (c) leverdisshmëria financiare dhe (d) parametrat teknikë dhe ato të mjedisit.

5. Zyra rajonale e APSH-së do t'i dërgojë raportin me përmbledhjen e propozimeve në APNSHS-së qendrore dhe PCU-në.

6. PCU-ja do të regjistrojë rezultatet në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Projektit dhe do t'i dërgojë raportet përmbledhëse në Komitetin Rajonal të Aprovimit për aprovimin final të propozimeve për nënprojektet e përzgjedhura.

**L I G J**  
**Nr.8821, datë 15.10.2001**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN  
NDËRKOMBËTARE TË EUROCONTROL-IT”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën Ndërkombëtare të EUROCONTROL-it për bashkëpunimin për sigurinë e navigimit ajror” të 13 dhjetorit të vitit 1960, të amenduar nga protokollin shtesë, i nënshkruar në Bruksel, më 6 korrik 1970, i cili është amenduar nga protokollin i 21 nëntorit të vitit 1978, të gjitha këto të amenduara nga protokollin i nënshkruar në Bruksel më 12 shkurt 1981.

Neni 2

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen shumëpalëshe për pagesat e rrugës” të 12 shkurtit të 1981.

Neni 3

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin që konsolidon “Konventën Ndërkombëtare të EUROCONTROL-it” dhe amendamentet e saj, hapur për nënshkrim në Bruksel më 27 qershor 1997.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3122, datë 22.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**L I G J**  
**Nr.8822, datë 15.10.2001**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.5, DATË 31.8.2001  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8668, DATË  
23.10.2000 “PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË  
SHTETIT””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Neni 1

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit nr.5, datë 31.8.2001 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit””.

**Shpallur me dekretin nr.3123, datë 22.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**L I G J**  
**Nr.8823, datë 18.10.2001**

**PËR BUXHETIN FAKTIK TË VITIT 2000**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 pika 4 e 5 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Miratohet Buxheti faktik i vitit 2000 dhe burimet e financimit të tij si më poshtë:

1. Buxheti i Shtetit:		
- Të ardhurat, gjithsej.....	100 584	milion lekë
- Shpenzimet, gjithsej .....	150 021	milion lekë
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore:		
- Të ardhurat .....	28 012	milion lekë
- Shpenzimet .....	28 948	milion lekë
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore:		
- Të ardhurat.....	2 816	milion lekë
- Shpenzimet .....	2 427	milion lekë
4. Deficiti buxhetor.....	49 984	milion lekë
5. Financimi i deficitit.....	49 984	milion lekë
Nga i cili:		
Financimi i brendshëm.....	26 944	milion lekë
- Kredi nga Banka e Shqipërisë .....	6 000	milion lekë
- Bono thesari .....	14 012	milion lekë
- Të ardhura nga privatizimi .....	8 932	milion lekë
- Ndryshimi i gjendjes së arkës.....	- 2 487	milion lekë
- Të tjera.....	487	milion lekë

Financimi i huaj, neto.....	23 040	milion lekë
Nga i cili:		
Mbështetje buxhetore.....	4 659	milion lekë

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3124, datë 22.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**V E N D I M  
Nr.563, datë 13.10.2001**

**PËR DHËNIE NDIHME TË MENJËHERSHME PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË  
SHËRBIMIT TË VARRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "d" të pikës 2 të nenit 64 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe të neneve 11 e 17 të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", me propozimin e Ministrisë të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Paraardhësve, pasardhësve ose personave që organizojnë funeralin dhe paguajnë shpenzimet e varrimit të ish-punonjësit aktiv të Policisë së Shtetit, në dispozicion, të pezulluar, me pagesë kalimtare, në pension, student, kursant ose ushtar dhe punonjësve civilë, efektivë në strukturat e Policisë së Shtetit u jepet ndihmë e menjëhershme për përballimin e shpenzimeve shtesë të varrimit, si më poshtë vijon:

- a) Gjashtë paga referuese mujore të muajit të fundit për ish-punonjësit aktivë të Policisë së Shtetit;
- b) gjashtë paga referuese mujore të muajit të fundit të dispozicionit për ish-punonjësën në dispozicion;
- c) gjashtë paga referuese mujore të muajit të fundit për ish-punonjësit e pezulluar;
- d) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të Policisë për ish-punonjësit me pagesë kalimtare;
- e) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të policisë për ish-pensionisët, për burrat me vjetërsi shërbimi jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe për gratë jo më pak se dymbëdhjetë vjet;
- f) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të Policisë për ish-studentët;
- g) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të Policisë për ish-kursantët ose ish-ushtarët;
- h) gjashtë paga mujore për ish-punonjësit civilë efektivë në strukturat e Policisë së Shtetit.

2. Personat përfitues sipas pikës 1 të këtij vendimi përcaktohen me urdhër të Ministrisë të Rendit Publik.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

**KRYEMINISTRI  
Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.102, datë 28.7.2001**

**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	" "
Gjergj Sauli	Anëtar i	" "
Alfred Karamuço	Anëtar i	" "
Kristofor Peçi	Anëtar i	" "
Kujtim Puto	Anëtar i	" "
Tefta Zaka	Anëtare e	" "
Sokol Sadushi	Anëtar i	" "
Petrit Pilloçi	Anëtar i	" "

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 26.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.106 Akti që i përket:

Kërkues:1.Subjekti zgjedhor "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar me prokurë nga Ilir Rusmajli.

2.Muslim Murrizi, kandidat për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar nga Ilir Rusmajli.

3.Partia Socialdemokrate, përfaqësuar nga avokat Mirash Martini.

Subjekte të Interesuara:

1.Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

2.Partia Socialiste, përfaqësuar nga Sokol Hazizi.

3.Partia Demokrate, përfaqësuar nga Sali Kelmendi.

4.Partia Agrare përfaqësuar nga Resmi Osmani.

5.Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, në mungesë.

**O B J E K T I:**

1.Shfuqizimi i vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mosshpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin në zonën zgjedhore nr.60".

2.Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Baza Ligjore: Neni 113 i Kodit Zgjedhor

Për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Zgjedhjeve kërkuesit "Bashkimi për Fitore" dhe kandidati për deputet Muslim Murrizi kanë parashtruar këto shkaqe:

- Për 19 qendrat e votimit, kutitë e votimit janë dorëzuar në komisionin e zonës zgjedhore të hapura.

- Në qendrat e votimit të komunës Ballagat materialet e votimit janë dorëzuar në orën 15.00 dhe 16.00 të ditës së zgjedhjeve.

- Në qendrën e votimit nr.4 komuna Karbunarë, fshati Zgjanë, si dhe në qendrën e votimit nr.9 komuna Tërbuf, fshati Shenepremte është konstatuar se janë hedhur në kutinë e votimit më shumë fletë votimi se numri i personave që kishin votuar deri në momentin e konstatimit.

Në shumë qendra votimi mungojnë listat, fletët e papërdorura, kundërbiletat dhe vulat.

Nga ana e saj, Partia Socialdemokrate ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:



- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në kundërshtim me nenin 18/4 të Kodit Zgjedhor, nuk ka shpallur rezultatin përfundimtar për qendrat e tjera, çka nuk na mundëson ankimin në këtë moment. Në këto rrethana, kërkesa jonë është njohja e rezultatit nul në 8 qendra votimi, siç është shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por deklarimi i panevojshëm përsëritja e zgjedhjeve në to si e pabazuar në ligj e në Kushtetutë, për këto arsye: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me të drejtë, ka vlerësuar se shkalla e dhunimit të procesit zgjedhor në zonën nr.60 në tërësi e bën të pavlefshëm rezultatin.

- Ribërja e zgjedhjeve për proporcionalin është në kundërshtim me nenin 64/2 të Kushtetutës, sipas të cilit, për llogaritjen e proporcionalit, njihen vetëm votat e vlefshme të fituara nga partitë e koalicionet në raundin e parë. Pra, Kushtetura lejon vetëm një raund për proporcionalin. Raundi i parë është faza e kualifikimit të partive për të parë se kush kalon pragun e 2.5%. Bërja a ribërja e zgjedhjeve, qoftë edhe pjesërisht, i kthen ato në një lojë politike të barazvlefshme me manipulimin.

- Përsëritja e zgjedhjeve për proporcionalin cenon lirinë dhe barazinë e votës, të sanksionuar në nenin 45/4 të Kushtetutës.

- Barazia e votës cenohet dukshëm edhe për vlerën e efektin që ajo merr gjatë përsëritjeve të zgjedhjeve për proporcionalin. Dhjetra vota në Lushnjë përcaktojnë fatin e 18 deputetëve, pra dhjetra vota marrin vlerën e 180 mijë votave, kur dihet se në proporcional Shqipëria është e gjitha një zonë e vetme elektorale e, si e tillë, vota e gjithkujt duhet të ketë të njëjtën vlerë, pavarësisht nga zona ku votohet, gjë që realizohet vetëm duke patur një raund zgjedhjesh.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, kërkuesit e përfaqësuesit e tyre, subjektet e interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

#### V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendim nr.191, datë 22.7.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.60; të shpallen të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit nr.1 dhe 6 të Komunës Ballagat; nr.1 dhe 11 të komunës Dushk; nr.1 dhe 6 të komunës karbunarë, si dhe nr.1 dhe 1/1 të komunës Hysgjokaj në zonën zgjedhore nr.60 dhe përsëritjen e zgjedhjeve në këto qendra votimi si për kandidatin e drejtpërdrejtë, dhe për subjektet politike, në datën 29 korrik 2001.

Kundër vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese kërkuesit koalicioni "Bashkimi për Fitore" dhe kandidati për deputet Muslim Murrizi, të cilët kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim edhe Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, e cila kërkon shfuqizimin pjesërisht të tij. Meqë kërkuesit kanë kundërshtuar të njëjtin vendim të Komisionit të Zgjedhjeve, Gjykata Kushtetuese vendosi t'i shqyrtojë këto kërkesa në një gjykim të vetëm.

Kërkuesit "Bashkimi për Fitore" dhe kandidati Muslim Murrizi, në ankimin e tyre kanë pretenduar se, për disa qendra votimi, kutitë e votimit janë dorëzuar në komisionin e zonës zgjedhore të hapura; në dy qendra votimi materialet e votimit janë dërguar me vonesë; në dy qendra votimi janë gjetur më tepër fletë votimi se numri i votuesve që kishin votuar deri në momentin e konstatimit; në shumë qendra votimi mungojnë fletët e papërdorura, kundërbiletat dhe vulat.

Në kundërshtim me sa pretendohet, në përfundim të gjykimit u provua se, me përjashtim të gjashtë qendrave të votimit, për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur përsëritjen e zgjedhjeve në datën 29.7.2001, nuk rezultoi që kutitë e votimit të jenë dërguar të hapura në Komisionin Zgjedhor të Zonës nr.60. Është e vërtetë, që siç është konstatuar, ka pasur raste kur

vula është gjetur jashtë ose në ndonjë rast listat e zgjedhësve janë gjetur jashtë kutisë së votimit, por këto parregullsi, në vetvete, nuk mund të përbëjnë shkak për të vënë në dyshim vlefshmërinë e zgjedhjeve në këto qendra votimi.

Edhe pretendimi se në dy qendra votimi janë gjetur në kuti më tepër fletë votimi se numri i

zgjedhësve në momentin e verifikimit, nuk u gjet i privuar. Lidhur me këtë pretendim nuk rezulton që komisionerët e koalicionit "Bashkimit për Fitore" në komisionet e qendrave të votimit të kenë shënuar vërejtjet e tyre në procesverbalet apo në tabelat modelare të rezultateve. Vetëm dokumente të tilla, sipas Kodit Zgjedhor, njihen si dokumente zyrtare dhe, si të tilla, kanë fuqi të plotë provuese. Çdo procedurë tjetër dokumentare jashtë atyre që parashikon Kodi Zgjedhor është e dyshimtë e, si e tillë, nuk mund të merret për bazë.

Nga ana e saj, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese anulimin e pjesëshëm të vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke urdhëruar që, për 8 qendrat e votimit për të cilat është udhëzuar përsëritja, të mos përsëriten zgjedhjet. Në ankimin e saj Partia Socialdemokrate ka parashtruar se përsëritja e zgjedhjeve për proporcionalin vjen në kundërshtim me nenin 64/2 të Kushtetutës, sipas të cilit, për llogaritjen e proporcionalit njihen vetëm votat e vlefshme të fituara nga partitë a koalicionet në raundin e parë; se Kushtetuta lejon vetëm një raund për proporcionalin dhe se raundi i parë është faza e kualifikimit të partive për të parë se cila kalon pragun e 2.5%; se bërja e zgjedhjeve, qoftë edhe pjesërisht, i kthen ato në një lojë politike të barasvlefshme me manipulimin; se përsëritja e zgjedhjeve për proporcionalin cenon lirinë dhe barazinë e botës, të sanksionuar në nenin 45/4 të Kushtetutës, se barazia e votës cenohet dukshëm edhe për vetë vlerën dhe efektin që ajo merr gjatë përsëritjes së zgjedhjeve për proporcionalin.

Në kundërshtim, sa pretendon pala kërkuese, Gjykata Kushtetuese konkludon se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për përsëritjen e zgjedhjeve në 8 qendra votimi të zonës zgjedhore nr.60, nuk vjen në kundërshtim me nenin 64/2 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve. Për zgjedhjet e këtij viti për Kuvendin e Shqipërisë, raundi i parë u përcaktua të bëhej më datën 24 qershor, ndërsa për zonën zgjedhore nr.60, meqë raundi i parë nuk u organizua në datën e mësipërme, u caktua të bëhej më datën 8 korrik. Pas zgjedhjeve të organizuara në këtë zonë më datën 8 korrik, meqë u konstatuan shkelje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në 8 qendra votimi më datën 29 korrik. Në këto rrethana, zgjedhjet në zonën zgjedhore nr.60 në datat 8 dhe 29 korrik, në kuptim të dispozitës së mësipërme të Kushtetutës, përbëjnë raund të parë të zgjedhjeve. Ky raund dallon nga raundi i dytë i zgjedhjeve, që sipas 2/18 të Kodit Zgjedhor, është zhvillimi i një votimi të dytë në një njësi zgjedhore për shkak se asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar të votave në datën e zgjedhjeve, sipas këtij Kodi. Për pasojë, edhe zgjedhjet e datës 29 korrik në 8 qendra votimi të zonës zgjedhore nr.60, janë pjesë e raundit të parë të zgjedhjeve, nga i cili, në vështrim të dispozitës së mësipërme të Kushtetutës, përcaktohet edhe numri i përgjithshëm i deputetëve.

PSD ka pretenduar, gjithashtu, se këto zgjedhje të datës 29 korrik, në këto qendra votimi, nuk duhet të bëhen. Në këtë drejtim arsyetohet se në këtë kohë gati në të gjithë vendin zgjedhjet kanë përfunduar. Jo vetëm kaq, por subjektet zgjedhore kanë ardhur në dijeni të rezultatit si për mazhoritarin, ashtu edhe për proporcionalin, qoftë edhe në mënyrë të përafërt. Në këto kushte, arsyetohet se ndonjë parti që ka marrë në mazhoritar më tepër mandate se sa mund të fitonte në tërësi nga proporcionali, mund të bëjë lojra politike, që në vetvete përbëjnë manipulim të zgjedhjeve, duke shkelur kështu standardin kushtetues të barazisë së votës.

Edhe ky pretendim nuk është i bazuar. Së pari, e drejta e shtetasve për të zgjedhur është një e drejtë kushtetuese, që nuk mund të mohohet. Në rastin në shqyrtim edhe banorët që mbulohen nga 8 qendrat e mësipërme të votimit, të cilët sipas nenit 45/1 të Kushtetutës kanë të drejtë të zgjedhin, përderisa nuk u është krijuar mundësia ta ushtrojnë këtë të drejtë me datën 24 qershor, kjo e drejtë nuk mund t'u mohohet ta ushtrojnë në një datë tjetër. Pretendimi se duke mos u kryer zgjedhjet për proporcionalin më datën 24 qershor, por në një datë tjetër të mëvonshme, ekziston mundësia e

manipulimit të tyre, ka të bëjë me atë se si do të zbatohet Kodi Zgjedhor. Pra, ky mund të jetë një konflikt paszgjedhor, i cili do të zgjidhet sipas procedurave që përcakton Kodi Zgjedhor. Nga ana tjetër, mundësia që zgjedhjet të mos organizohen në përputhje me rregullat që përcakton ky Kod, nuk përbën shkak që ato të mos zhvillohen fare. Një gjë e tillë do të shkelte të drejtën kushtetuese të shtetasve për t'u zgjedhur.

Për sa sipër, të dyja kërkesat duhet të rrëzohen si të pabazuara.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/e dhe 132 të Kushtetutës, neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

#### V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës të kërkuesve Koalicionit "Bashkimi për Fitore" dhe kandidatit për deputet Muslim Murrizi për shfuqizimin e vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si të pabazuar.

2.Rrëzimin e kërkesës së Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë për shfuqizimin e pjesëm të vendimit 191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si të pabazuar.

3.Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

#### MENDIM I PAKICËS

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.191, datë 22.7.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.60, si dhe të shpallë të pavlefshme zgjedhjet në 6 qendra votimi, duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në këto qndra votimi si për kandidatin e drejtpërdrejtë, dhe për subjektet politike.

Kundër vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit të Zgjedhjeve kanë bërë ankim në Gjykatën Kushtetuese, kandidati për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore" Muslim Murrizi dhe subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, që kërkon shfuqizimin pjesërisht të vendimit të sipërpërmendur.

1.Mendoj se kërkuesi Muslim Murrizi ka paraqitur provat e mjaftueshme për të vërtetuar shkeljet e bëra në zonën zgjedhore nr.60.

Shumica në vendimin e saj nuk i ka patur parasysh këto prova, si dhe faktin se parregullsitë e konstatuara kanë patur një ndikim përcaktues në rezultatin e zgjedhjeve. Ky ndikim është i lidhur me rëndësinë, diversitetin dhe shumëllojshmërinë e parregullsive të kryera gjatë procesit zgjedhor në zonën zgjedhore nr.60.

Shumica arsyeton se pretendimi që në dy qendra votimi materialet janë dërguar me vonesë, në kundërshtim me nenin 89/2 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit komisionet e qendrave të votimit duhet t'i merrnin materialet e votimit jo më vonë se 12 orë përpara hapjes së votimit, nuk provohet.

Në kundërshtim me sa arsyeton shumica, kërkuesi ka dorëzuar dy procesverbale të nënshkuara nga anëtarët të KZZ-së dhe të KQV-së, që mbajnë datën 8.7.2001, ku përcaktohen rastet kur materialet e votimit janë dorëzuar me vonesë, në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor. Konkretisht, bëhet fjalë për qendrën e votimit në Manasufaj, ku materialet janë dorëzuar në orën 15.00 dhe në Zgjanë, komuna Karbunarë.

Gjithashtu, shumica arsyeton se kutitë e votimit nuk rezultojnë të jenë dërguar të hapura nga qendrat e votimit në Komisionin Zgjedhor të Zonës nr.60, megjithëse shumica pranon që janë gjetur vula ose lista të zgjedhësve jashtë kutive.

Ky konkluzion i shumicës mendoj se është i gabuar, sepse në materialet e paraqitura nga kërkuesi në seancë gjyqësore ndodhet edhe vendimi i Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.60, datë

11.7.2001, sipas të cilit kutitë e votimit nga pjesë e qendrave të votimit kanë ardhur të hapura, gjë kjo që vjen në kundërshtim me nenin 107 pika 1/b të Kodit Zgjedhor. Kjo gjë rezulton edhe nga procesverbalet e dorëzimit në Komisionin e Zonës Zgjedhore nr.60 të kutive të votimit, mbajtur më 8.7.2001 ku nuk janë shënuar kodet përkatëse.

Në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është pasqyruar hapja e kutive me kodet përkatëse, duke shënuar se vulat janë të njëjta me ato të procesverbalit të

identifikimit të vulave, gjë e cila nuk u provua në seancë gjyqësore.

Në procesverbalin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shumë qendra votimi janë lënë pa numër, megjithëse jepen të gjitha të dhënat për kutitë e votimit (fq.5, 10,19,32, etj të procesverbalit).

Një moment i rëndësishëm, i cili flet për një proces të parregullt, është edhe mbështetja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi tabelat e rezultateve të qendrave të votimit të fotokopjuara, një kopje e të cilave u paraqit para Gjykatës Kushtetuese e panoterizuar, gjë e cila vjen në kundërshtim me nenin 107 të Kodit Zgjedhor.

Në tabelat origjinale të paraqitura nga kërkuesi, vihen re korrigjime dhe mungesa nënshkrimesh.

Lidhur me pretendimin e kërkuesit se fletët e votimit të gjetura ishin më tepër se numri i zgjedhësve që kishin votuar, shumica arrin në konkluzionin se nuk u gjet i provuar.

Mendoj se ky konkluzion është i gabuar, pasi në procesverbalin e mbajtur më 8.7.2001 nga Komisioni i Qendrës së Votimit komuna Karbunarë dhe i nënshkruar si nga komisioni edhe nga vëzhguesit ka rezultuar se kanë qenë hedhur në kuti 36 fletë votimi më tepër se numri i zgjedhësve që kanë votuar në këtë qendër.

Mbi bazën e tij, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.60 ka marrë vendim për të mos hedhur rezultatet e kësaj qendre votimi në tabelën përfundimtare.

Të gjitha këto parregullsi, si dhe parregullsi të tjera më të vogla të pasqyruara në procesverbalin e Komisionit të Zonës Zgjedhor dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në tërësi mendoj se e bëjnë procesin e votimit të pavlefshëm në zonën zgjedhore nr.60.2. Përsa i përket kërkesës së Partisë Socialdemokrate për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke urdhëruar që për 8 qendrat e votimit për të cilat është urdhëruar përsëritja të mos përsëriten zgjedhjet për proporcionalin, mendoj se nuk duhet kërkuar në këtë moment.

Kjo për faktin se rezultati për proporcionalin nuk ka dalë dhe nuk mund të përcaktohet ndikimi që ka kjo zonë në ndarjen e mandateve në proporcional.

Për sa sipër, mendoj se kërkesa duhet të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese mbas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar për proporcionalin, duke vendosur pushimin e gjykimit në këtë Gjykatë.

#### **V E N D I M ( I S H K U R T U A R )**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Dibrës, me vendimin nr.98, datë 9.4.2001, shpall të zhdukur shtetasin Gjyzel Fida.

#### **V E N D I M ( I S H K U R T U A R )**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Dibrës, me vendimin nr.102, datë 10.4.2001, shpall të zhdukur shtetasin Atli Hakore.

#### **V E N D I M ( I S H K U R T U A R )**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Fierit, me vendimin nr.1052, datë 2.10.2001, shpall të zhdukur shtetasen Magdalena Sami Toma.

## **V E N D I M (I SHKURTUAR)**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Dibrës, me vendimin nr.275, datë 3.10.2001, shpall të zhdukur shtetasin Urim Topuzi.

### **KËRKESË**

Kërkuese: Xhevrije Mara, e bija e Sulejmanit dhe Selvijes, e datëlindjes 10.2.1967, banuese në lagjen 14, Shkozet, Durrës.

Person i tretë i interesuar: Zyra e Gjendjes Civile Durrës

Objekti: Shpallja e zhdukjes së bashkëshortit tim Lutfi Mara

Bashkëshorti im Lutfi Jakup Mara, i datëlindjes 5.1.1962, ka dalë nga shtëpia më datë 10.5.1999, me një motor të vogël për të blerë disa gjëra dhe nuk u kthye më.

Më datë 12.5.1999 kemi edhe një denoncim në polici, e cila, përveç kërkimit nga ana e saj, na këshilloi të bënim edhe një denoncim në prokurori, ku çështjen në atë kohë e mori oficeri i policisë gjyqësore, Petrit Çeveli.

Që nga ai moment as unë, as njerëzit e tim shoqi dhe as tre fëmijët tanë nuk kemi dëgjuar asnjë të dhënë për të.

Po kështu edhe nga policia apo nga prokuroria nuk kemi marrë asnjë informacion të ri mbi të.

**KËRKUESE  
Xhevrije Mara**

### **KËRKESË**

Kërkuesi: Selim Çeliku, i biri i Hasanit dhe Nadires, lindur dhe banues në Stërmas të Tiranës.

Objekti: Vërtetimin e faktit juridik të vdekjes së Mine Çelikut.

Mine Çeliku, e lindur më 20.1.1876, figuron e gjallë në një kohë që ajo ka vdekur në muajin dhjetor 1943 dhe për shkaqe lufte nuk është kryer regjistrimi i vdekjes.

E bëjmë këtë kërkesë për të rregulluar problemet tona pasurore, si dhe për plotësimin e dokumenteve nga organet përkatëse.

**KËRKUESI  
Selim Çeliku**

### **KËRKESË**

Kërkuesi: Shefqet Xhukellari, i biri i Aliut e Adevis, lindur dhe banues në Vërdovë të Pogradecit.

Objekti: Shpalljen të vdekur të shtetasit Artan Shefqet Xhukellari, i biri i Shefqetit dhe Fidaries, lindur në Vërdovë të Pogradecit më 9.7.1967.

Në fund të vitit 1992, Artani së bashku me dy shokët e tij Bashkim Hamdi Latifllari dhe Fatos Aqif Latifllari është nisur malit për në Greqi. Atje ka punuar rreth katër vjet në qytetin Volos së bashku me vëllanë e tij, Besnikun. Në muajin qershor 1999, Artani ka njoftuar në telefon se do të

kthehej në Shqipëri bashkë me të vëllanë. Rrugës për në Atdhe kanë kaluar maleve pasi kishin shumë dhrahmi me vete. Artani ka rrëshqitur dhe ka rënë në një humnerë të thellë maleve të

Greqisë. Besniku ka njoftuar policinë greke, po pas kërkimeve të shumta nuk u gjend trupi i Artanit.

Kanë kaluar më shumë se dy vjet nga kjo fatkeqësi dhe nuk kemi asnjë të dhënë për të, prandaj kërkojmë shpalljen e tij të vdekur.

**KËRKUESI**  
**Shefqet Xhukellari**

### **KËRKESË**

Kërkuese: Iris Ferhati, e bija e Mahmutit dhe Barijes, e datëlindjes 1965, lindur në Sotirë të Gramshit dhe banuese në fshatin Darëzezë të komunës Dermenas.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit tim Halit Shaban Ferhati.

Bashkëshorti im Halit Ferhati më 23 prill 1991 është larguar nga shtëpia për në Greqi për të punuar si emigrant ekonomik. Nga çasti i nisjes e deri më sot nuk kam asnjë informacion për vendndodhjen e tij, as postar, as telefonik, as gojor nga persona të tjerë. Edhe të afërmit e tij, gjithashtu, nuk kanë asnjë të dhënë. E kemi kërkuar nëpërmjet Kryqit të Kuq Shqiptar, me anë të radios e televizionit madje, unë kam shkuar vetë edhe në Greqi, po nuk kemi arritur të zbulojmë diçka.

Në këto kushte, kur unë dhe vajza jonë Ditjona Ferhati kemi interesa nga fakti i deklarimit të tij si i zhdukur, detyrohem ta kërkoj këtë nëpërmjet rrugës gjyqësore.

**KËRKUESE**  
**Iris Ferhati**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 23.10.2001  
Doli nga shtypi më 26.10.2001

Tirazhi: 4210 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë